



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Financë”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr Drini Salko

Prof.Asoc.Dr Orkida Ilollari

Nëntor / 2025

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE NË “FINANCË”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkenave në “Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr.510, datë 08.11.2010 *
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 297, datë 20.07.2012 **
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 30 PAE / 6 PAK; 2023-2024 35 PAE / 11 PAK; 2024-2025 31 PAE / 9 PAK:
18	Numri i studentëve:	2022-2023 119 studentë; 2023-2024 120 studentë; 2024-2025 121 studentë;
19	Komente / të tjera:	• Emërtimi i programit sipas aktit të licensimit është: Master i Shkencave në Financë me profil: i) Drejtues financiar; ii) ndërmjetës bankar; iii) ndërmjetës jobankar;

	<ul style="list-style-type: none"> • ndërsa sipas urdhërit për regjistrimin e formës së diplomës është: Master i Shkencave në: "Financë"
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

*Emërtimi sipas aktit të licensimit është: Master i Shkencave në Financë me profil: i) Drejtues financiar; ii) ndërmjetës bankar; iii) ndërmjetës jobankar;

**Emërtimi sipas urdhërit për regjistrimin e formës së diplomës është: Master i Shkencave në: "Financë";

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin e KM. Nr. 207, datë 30.05.1957. Përgjatë viteve ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh, kryesisht në strukturën e tij. Në vitin 1991, nga UT (në atë kohë me 11 fakultete) u shkëputën fakultetet inxhinierike dhe u krijua Universiteti Politeknik i Tiranës. Në Janar të vitit 2013, u shkëputën dhe dy fakultete të shkencave mjekësore, për të krijuar Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

UT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, dhe në Filialin e tij në qytetin e Sarandës. Sipas strukturës aktuale, ky universitet përbëhet nga një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute. Universiteti i Tiranës ka kaluar disa procese akreditimi institucionale, ku së fundmi është akredituar institucionalisht me vendimin Nr. 04, datë 27.01.2023 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 6 vite, me afat vlefshmërie deri në 26.01.2029. Fakulteti i Ekonomisë si një nga fakultetet e UT është njësia kryesore përgjegjëse e këtij programi studimi, dhe që përfshin 6 departamente.

Programi i studimit Master i Shkencave në Financë është hapur sipas Urdhër MASH Nr.510, datë 08.11.2010, me emërtimin (Master i Shkencave në Financë me profil: i) Drejtues financiar; ii) ndërmjetës bankar; iii) ndërmjetës jobankar;). Sipas Urdhërit të MASH Nr. 297, datë 20.07.2012 "Për regjistrimin e formës së diplomave të programeve të studimeve "Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" të Universitetit të Tiranës", emërtimi i këtij program studimi është Master i Shkencave në "Financë", sipas të cilit funksionon. Si një program i ciklit të dyte ai synon tu japë studenteve njohuri të thelluara teorike shkencore si dhe aplikative për të qene konkurrues në tregun e punës dhe të afte për të përballuar sfidat e zhvillimit dinamik që ndodhin në sektorin financiar. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Programi organizohet nga Departamenti i Financës që mbart eksperiencën shumë të gjatë të veprimtarisë së tij dhe imazhin pozitiv të mjaft brezave studentesh të diplomuar në këtë dege të ekonomisë shqiptare. Departamenti i Financës ofron 1 program studimi të nivelit Bachelor, 3 programe studimi të nivelit Master dhe një program studimi të ciklit të trete të studimeve të doktoratures. Ky program studimi akreditohet për herë të parë. në përfundim të studimeve në këtë program lëshohet Diploma Master i Shkencave në "Financë"

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përbërë nga **Prof. Dr. Drini Salko** dhe **Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari**, u caktua nga Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, GVJ u mbështet nga znj. Majlinda Demirneli, koordinatore teknike pranë ASCAL. Vlerësimi u bazua në dokumentacionin e dërguar nga ASCAL dhe materialet shtesë të siguruar nga institucionet përkatëse.

Një komponent thelbësor i këtij procesi ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), hartuar në bashkëpunim nga stafi akademik dhe administrativ i institucionit, i cili ofroi një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar të gjendjes aktuale në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT), përfshirë Departamentin e Financës, që administron programin Master i Shkencave në “Financë”.

Në datat 15-16 shtator 2025, GVJ realizoi vizitën pranë institucionit, gjatë së cilës zhvilloi takime me drejtuesit e njësive akademike dhe administrative të FEUT, analizoi dokumentacionin për akreditim, si dhe kreu intervista me hartuesit e RVB-së, anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), pedagogë, personel ndihmës-akademik dhe studentë të programit. Pjesë e vizitës ishte edhe inspektimi i ambienteve fizike të universitetit në funksion të programit të studimit.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është ndërtuar mbi gjashtë standarde kryesore, të cilat analizohen në mënyrë të detajuar sipas kriterëve përkatëse, duke u mbështetur në të dhënat e RVB-së, dokumentacionin shtesë dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në terren. Ekspertët shqyrtuan përmirësimet e realizuara dhe ndikimin e tyre në arritjen e standardeve, duke ofruar për secilin standard një vlerësim të qartë dhe komente analitike. Për të vlerësuar realisht situatën, u përzgjedhën kampionë për analizë të të dhënave në mënyrë të rastësishme, për të kontrolluar cilësinë e studentëve, evidencat në sekretarinë mësimore, regjistrimet dhe diplomimet, ndjekjen e leksioneve dhe seminareve, si dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik.

GVJ evidentoi bashkëpunimin korrekt të strukturave të institucionit, të cilat ofruan pa vonesë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke krijuar kushtet për një vlerësim objektiv dhe të paanshëm. Raporti përfaqëson qëndrimin e përbashkët të ekspertëve të jashtëm dhe është hartuar në koordinim të plotë ndërmjet tyre.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 138/11 Prot, datë 27.10.2025. Universiteti i Tiranës përcjell nëpërmjet sistemit më datë 10.11.2025, komentet mbi draft raportin. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- 1. Duke ju referuar standartit IV.1, kriteri 1, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se, ndonëse në këtë fazë tabelat e korrigjuara nuk mund të pranohen zyrtarisht, ato janë shqyrtuar nga GVJ dhe u konstatua se: në këtë program studimi, është vënë re përsëri angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik që zotëron vetëm gradën “Master i Shkencave (MSc)”, çka**

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

përbën mospërputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 59, pika 6, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “personeli akademik që angazhohet në procesin mësimor duhet të zotërojë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës”. Në këtë kontekst, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mban të njëjtin vlerësim si në vlerësimet e mëparshme, **raporti nuk ndryshon.**

2. Duke ju referuar standartit VI.1, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), pas shqyrtimit të evidencës shtesë të paraqitur, konkretisht dokumentit “Evidenca mbi rezultatet e përfituara nga Paketa e Cilësisë NJSBC për vitin 2025”, vlerëson se kjo evidencë demonstroi përmirësime të dukshme në përmbushjen e kërkesave të standardit përkatës. Në këtë kontekst, GVJ konkludon se: Vlerësimi për Standardin VI.1 ndryshon nga **“Përmbushet kryesisht”** në **“Përmbushet plotësisht”**

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DF	Departamenti i Financës
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
KPSSC	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
SBC	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
UT	Universiteti i Tiranës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKK	Zyra e Këshillimit të Karrierës

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave në “Finance”, ofruar nga Universiteti i Tiranës (UT), Fakulteti i Ekonomisë (FE), si njësi kryesore dhe Departamenti i Financës (DF) si njësi baze në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Programi bazohet në Statutin e institucionit si dhe përkon edhe me zhvillimin institucional, akademik dhe shkencor të përcaktuara në strategjinë e UT për mësimdhënien për periudhën 2022-2027 dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni 2023-2028. në faqen nr.6 të këtij dokumenti theksohet objektivi strategjik dhe qëllimi “i kësaj qasjeje është të ofroje mundësi për studentet me aftësi në tregun e punës si dhe si qytetare të angazhuar në shoqëri”. Si një program bashkëkohor ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti.</p> <p><i>Evidenca nr.1.1.Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidenca nr. 1.5. Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT 2022-2027</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Financë” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UT-së dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e tij, të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e financës në përgjithësi por edhe të menaxhimit financiar në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamentit i Financës, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë të UT-së. Këtij qëllimi i shërben edhe vete plani</p>


	<p>strategjik i vete programit të studimit për periudhën 2020-2025. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me një nivel me të larte shkencor dhe aplikativ në financë në përputhje me objektivat e një programi të ciklit të dyte në nivel Master. Ky program studimi i referohet tregut financiar në Shqipëri i cili është gjithnjë e me shume dinamik dhe në zhvillim rrjedhoje kjo edhe e prirjeve dhe novacionit që e karakterizon.</p> <p><i>Evidenca nr.1.1.Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidenca nr. 1.5. Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT 2022-2027</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.2. Plani strategjik i programit MSH në "Finance"</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin baze të institucionit(UT), statutin dhe strategjitë e zhvillimit të tij dhe fushat akademike në nivel institucional, njësie kryesore (FE) dhe atë baze (DF), ky program studimi ofrohet plotësisht në zbatim të strategjive në fushën e ekonomisë në përgjithësi dhe atë të financës në veçanti.</p> <p>UT si institucion, FE si njësi kryesore dhe DF si njësi baze janë struktura me historikun me të gjate të arsimit të larte shqiptar dhe që reflektuan me se miri ndryshimet politike, ekonomike e sociale të pas vitit 1990 duke synuar zhvillimin akademik në përshtatje me këto ndryshime duke transmetuar njohuritë bashkëkohore edhe në fushën e financës.</p> <p><i>Evidenca nr.1.1.Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidenca nr. 1.5. Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT 2022-2027</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.2. Plani strategjik i programit MSH në "Finance"</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e financës me fokus kryesor sektorin financiar e bankar i shërben këtij zhvillimi. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën e financës që përbejnë një drejtim të rëndësishëm edhe për nevojat e tregut për</p>

dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>specialist me njohuri të thelluara në këtë drejtim. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e trajtimeve bashkëkohore dhe të thelluara të sektorit financiar në Shqipëri që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive në këtë fushë.</p> <p><i>Evidenca nr.1.1.Statuti i UT</i> <i>Evidenca nr.1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i> <i>Evidenca nr. 1.5. Strategjia institucionale për mësimdhënien në UT 2022-2027</i> <i>Evidenca nr.3.2. Plani strategjik i programit MSH në "Financë"</i> <i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në "Financë"</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit të ciklit të II-te Master i Shkencave në "Financë" është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UT duke u bazuar në strategjitë e zhvillimit të institucionit dhe njësisë kryesore si dhe të vete këtij programi.</i></p> <p><i>Ky program mbështetet në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë që është financa.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Organizimi i UT, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në "Financë", duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. UT është IAL me historikun me të gjatë dhe me struktura tashme të konsoliduar prej vitesh. UT ka në përbërjen e tij 6 fakultete, 2 institute dhe 1 filial.</p>

	<p>Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Financës si njësi baze që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit, ai përfshin gjashtë Departamente me një personel akademik efektiv ((PAE) prej 168 punonjësish me kualifikimet akademike të konsoliduar dhe që përfaqëson FE me të hershem dhe me të madh në vend.</p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i> <i>Evidenca nr.3.8.Përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela 1)</i> <i>Evidenca nr. 2.33.Organigrama e FE të UT</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi MSH në Financë funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit MSH në Financë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë si një ndër 6 fakultetet e UT.</p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i> <i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i> <i>Evidenca nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela 1 dhe 2)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti i Financës i cili mbulon këtë program. Jo vetëm emërtimi është i njëjtë me objektivin e këtij programi por edhe kualifikimet e stafit akademik të kësaj njësie baze që mbulon programin është me kualifikuar dhe me eksperience akademike e shkencore në fushën e financës.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i> <i>Evidenca nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela 1 dhe 2)</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.3.10. Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidence nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB(tabela 1, 2,3 dhe 4)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe zyrën e karrierës dhe Alumni evidentohet informacioni i ruajtur për studentet e diplomuar në këtë program. Gjithashtu evidentohet edhe bashkëpunimi me ish studente të diplomuar dhe të punësuar në institucionet financiare apo kompani të biznesit në sektorin e financës. në funksion të këtij qëllimi janë organizuar disa workshop-e apo tryeza të rumbullakëta për tema të caktuara në fushën e financës ku nja pjese e pjesëmarrësve kane qene ish studente të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca nr. 2.23.Lista e marrëveshjeve ndërinstitutionale kombëtare e FE të UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.28.Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17.Workshop:Vleresim i kompetencës teknike profesionale për studentet e sapo diplomuar në MSH në Finance, 2025.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.25. Statistika të Alumni” Master i Shkencave në Finance, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.Analiza e tregut të punës dhe Alumnit, FE për studentet e Departamentit të Financës.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.16. Lista e leksioneve të hapura të zhvilluara në ciklin e dyte të studimeve me pjesëmarrje të studenteve MSH në Finance, 2021-2025</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it vizitës në institucion dhe takimit me stafin dhe studentet vlerëson se ky program studimi është në përputhje me fushën akademike të FE si njësi kryesore dhe të DF si njësi baze përgjegjëse e programit.</i></p>

	<i>Kualifikimet e stafit akademik që zhvillojnë këtë program pjesa me e madhe e të cilit përfshihet në strukturën e DF janë në fushën e Financës që përkon edhe me fokusin kryesor të këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UT si institucion dhe brenda FE si njësi kryesore e programit dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësi mes njësisë kryesore, njësisë bazë dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sërë aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin e UT (neni 11, pika V, neni 12, 14 dhe 19) rregullore e UT (kreu III), rregullore e programit të studimit dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Po ashtu janë një sërë aktesh të tjera që disjplinojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësi e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p>Struktura e institucionit përfshin të gjitha hallkat e nevojshme në funksion të procesit mësimor shkencor ashtu edhe të zbatimit dhe monitorimit të standardeve të cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies duke përfshirë edhe ato në funksion të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore (NJSBC, Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë)</p> <p>Institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arrijten dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Në këto</p>

	<p>dokumente janë të përcaktuar qartë drejtimit e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësi të gjitha njësive përkatëse.</p> <p>Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti i Financës. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykojnë të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidenca nr 1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.33. Organigrama e FE të UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Analiza vjetore e Departamentit të Financës FE për vitin 2022-2023, 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se UT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër institucioneve dhe subjektsh ekonomike shtetërore dhe private. Këto marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS + ; IPA etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Sipas listës së</p>

	<p>bashkëpunimit ndërinstitucional të FE dhe bazuar në tabelën përmbledhëse statistikore të RVB nr. 5 dhe evidencën nr.2.33 si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, janë 45 marrëveshje bashkëpunimesh me aktorë të biznesit, institucione publike dhe private, bashkëpunime ndërinstitucionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda vendit dhe 26 me ato jashtë vendit. Si institucioni me i madh dhe i hershem i Arsimit të Lartë UT ka një sere marrëveshjes bashkëpunimi në rolin e partnerit në kuadër të programeve TEMPUS, ERASMUS Mundus Action2, IPA, Eureka etj. Personeli akademik i programit dhe studentet e këtij programi studimi janë përfitues të mobiliteteve të shumta në këto universitete partnere. Gjatë vizitës në institucion u evidentua edhe përfshirja e lektorëve të huaj për të dhënë leksione për tema të veçanta, ku një temë specifike është trajtuar me studentët e këtij programi dhe të programeve të tjera në fushën e ekonomisë</p> <p><i>Evidence nr.2.33. Lista e marrëveshjeve ndërinstitucionale kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel FE të UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UT dhe FE ka një sërë marrëveshjesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FE të UT, pedagogët pohuan kete, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën të tyre.</p> <p><i>Evidence nr.2.33. Lista e marrëveshjeve ndërinstitucionale kombëtare në nivel FE të UT</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga</p>	<p>Departamenti i Financës harton raporte të veçanta lidhur me veprimtarinë mësimore shkencore të njësisë, ku pjese e këtij raporti është dhe analiza e bashkëpunimin me entet e ndryshme. GVJ shqyrtoi raportet periodike të analizës mësimore shkencore të Departamentit, ku në to përfshihet edhe analiza e</p>

<p>marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>marrëveshjeve të bashkëpunimit me entet e ndryshme me fokus realizimin e intershipeve si dhe mundësi e punësimit pranë tyre të te diplomuarve në këtë program.</p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Analiza vjetore e Departamentit të Financës FE për vitin 2022-2023, 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.28.Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.16. Lista e leksioneve të hapura të zhvilluara në ciklin e dyte të studimeve me pjesëmarrje të studenteve MSH në Finance, 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17.Workshop:Vleresim i kompetencës teknike profesionale për studentet e sapo diplomuar në MSH në Finance, 2025.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë ", bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UT dhe institucioneve publike apo private si dhe sipërmarrjeve të ndryshme si dhe në një sere marrëveshjeve që vete FE ka me aktoret brenda dhe jashtë vendit duke mundësuar realizimin e shkëmbimit të përvojës akademike, e praktike, të kualifikimit të stafit si dhe të realizimit të intershipeve dhe marrjen e eksperiencës nga specialistë të fushës jashtë institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--------------------------------------------------------------------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Financë ” që ofrohet nga DF i Fakultetit të Ekonomisë pranë UT është organizuar në përputhje të akteve ligjore në fuqi, Ligjit nr.80/2015, akteve nënligjore si dhe vete kuadrin rregullator të institucionit hartuar në baze të tyre. Programi i studimit është i organizuar në 16 lende (përfshirë praktikën) të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë fizike.</p> <p>Programi bazohet në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjës. Programi me një kohëzgjatje 2 vite akademike është i ndarë në 4 semestra dhe që përfshin 120 ECTS. Programi ka gjithë elementet përkatës si ore në auditor, ore jashtë auditorit dhe ndarjen e tyre sipas semestrave. Edhe në hartimin e programeve të lendeve të veçanta janë përmbushur plotësisht kriteret nënligjore të përcaktuara.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1. Rregullore për organizimin e programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në financë (per 3 vitet e fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve mësimore të programit MSH në Finance. (te tre viteve të fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 10)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës, drejtimit financiar dhe aplikimit praktik të programeve financiare dhe ekonometrike duke reflektuar plotësisht nivelin e një programi të ciklit të dyte në financë. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në fushën e Financës, drejtimit financiar dhe riskut pranë institucioneve financiare,</p>

<p>të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik dhe atë të analizës ekonomike. Trajtimi në këtë program të menaxhimit financiar dhe risqeve në fusha të ndryshme të ekonomisë (sipërmarrjeve bankave tregtare etj), e bëjnë këtë program jo vetëm me të plote dhe bashkëkohor por dhe konkurrues krahasuar me tërësinë e programeve të financës që zhvillohen në vendin tonë nga institucionet e tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në financë (për 3 vitet e fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve mësimore të programit MSH në Finance. (te tre viteve të fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 10)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën për përgatitjen e punimit të mikrotezës me 18 kredite me të cilën studenti përmbyll këtë program duke marrë diplomën “Master i Shkencave” në “Financë”. Gjithashtu programi ka të përcaktuar në semestrin e dyte edhe praktiken me 12 kredite periudhe studimore kjo e rëndësishme ku studenti krahas njohurive profesionale realizon edhe punimin përmblyllës kërkimor me ane e një punimi diplome (mikroteze).</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në financë (për 3 vitet e fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve mësimore të programit MSH në Finance. (te tre viteve të fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 10)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.3. Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program</p>

<p>arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program</p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UT dhe FE si njësi kryesore ofron vetëm këtë program studimi MSH në Finance. Nga informacioni që GVJ ka, rezulton se programi MSH me këtë emërtim zhvillohet në disa prej në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, si Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti Europian, Universiteti i Gjirokastrës etj.</p> <p>Përmbajtja e programit duke marrë për bazë fushën e financës në kuadër të gjerë përmban jo me pak se 70 % të lendeve që zhvillohen në këto institucione të ngjashme të nivelit MSH. Nga ana tjetër, ky program studimi do ta konsideronim jo vetëm me historikun më të gjatë por edhe si më i konsoliduar, porë kjo në ecurinë e suksesshme të aplikimeve në fazën e regjistrimit dhe preferencës së tregut për të diplomuarit në këtë program.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në financë (për 3 vitet e fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve mësimore të programit MSH në Finance. (te tre viteve të fundit)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 10)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.3. Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi është tashme i kodifikuar. Në kuadër të zbatimit të VKM nr.310 datë 11.05.2022” me kodin 0412.</p> <p>Në kuadër të urdhrin nr.297. date 20.07.2012 të MASH me kodin 000633. Ky kodim siguron identifikimin e sakte të programit brenda sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe është pjese e regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave.</p> <p><i>Evidenca nr.2.29.Forme diplome dhe kodet e programeve</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.6.Formati i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në</p>	<p>Programi MSH në “Financë” aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p>

përputhje me legjislacionin në fuqi.	
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në "Financë" organizohet në përputhje me aktet ligjore (Ligji i arsimit të lartë nr.80/2015) dhe nënligjore (VKM Nr. 41, datë 21.01.2018) në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Programi i studimit përmban të gjithë elementët e një programi studimi të ciklit të dytë që ofron një IAL. Programi bazohet në Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve ECTS të llogaritura mbi elementet standarde të vlerësimit.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>FE si njësia kryesore e këtij program studimi përmbush detyrimet ligjore në organizim, strukturë dhe staf akademik. Kjo njësi përbëhet nga 6 Departamente që aktualisht zhvillojnë 33 programe studimi të në të tre ciklet e studimit të nivelit Bachelor, Master dhe Doktorature:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financës; 2. Departamenti i Kontabilitetit; 3. Departamenti i Ekonomiksit; 4. Departamenti i Menaxhimit; 5. Departamenti i Marketing Turizmit; 6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar; <p>FE për vitin aktual akademik 2024-2025 ka një staf akademik prej 168 PAE dhe 214 PAK me kualifikimin si më poshtë vijon:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Njësia bazë</th> <th>PAE</th> <th>Tituj/Grada</th> <th>PAK</th> <th>Tituj/Grada</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Departamenti i Financës</td> <td style="text-align: center;">29</td> <td>6 – Prof. Dr.</td> <td style="text-align: center;">36</td> <td>0 – Prof. Dr.</td> </tr> </tbody> </table>	Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada	Departamenti i Financës	29	6 – Prof. Dr.	36	0 – Prof. Dr.
Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada							
Departamenti i Financës	29	6 – Prof. Dr.	36	0 – Prof. Dr.							

			10-Prof.Asoc. 6- Dr. 7- Dr. në Proc		3- Prof. Asoc. 5- Dr. 11 - Dr. në Proc. 17- Msc
	Departamenti i Kontabilitetit	22	3- Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 8- Dr. 9 - Dr. në Proc. 0 - Msc	25	2- Prof. Dr. 0- Prof. Asoc. 2- Dr. 2 - Dr. në Proc. 19 - Msc
	Departamenti i Ekonomiksit	36	5 - Prof. Dr. 15- Prof. Asoc. 9 - Dr. 7 - Dr. në Proc. 0 - Msc	13	1- Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 1 - Dr. 4 - Dr. në Proc. 5 - Msc
	Departamenti i Menaxhimit	29	4 - Prof. Dr. 7- Prof. Asoc. 7- Dr. 11 - Dr. në Proc. 0 - Msc	49	1 - Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 11 - Dr. 10 - Dr. në Proc. 25- Msc
	Departamenti i Marketing Turizëm	18	4 - Prof. Dr. 4- Prof. Asoc. 6- Dr. 4 - Dr. në Proc. 0 - Msc	36	1- Prof. Dr. 1- Prof. Asoc. 4- Dr. 15 - Dr. në Proc. 15 - Msc
	Departamenti i Statistikës dhe Informatikës se Zbatuar	34	6- Prof. Dr. 12- Prof. Asoc. 5- Dr. 11 - Dr. në Proc.	62	1 - Prof. Dr. 4- Prof. Asoc. 17- Dr. 6 - Dr. në Proc.

	0 - Msc	34 - Msc
Total	168	221

Departamenti i Financës si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara, si dhe i përmbush detyrimet për numrin e personelit dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë vijon:

Departamenti i Financës

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	4	1	4	1	6	
Prof. Asoc.	10	3	10	3	10	3
Dr./PhD.	8	4	8	4	6	5
Dok.në proces dhe MSc	8	38	8	27	7	28
Totali	30	45	30	35	29	36

Siç shihet edhe nga tabelat e mësipërme stafi i të DF përgjegjës për këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore, i qëndrueshëm në numër dhe në kualifikimet e kërkuara duke përberë një garanci të madhe për realizimin e këtij programi.

Evidenca nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.1 dhe 2)

Evidenca nr. 3.7.CV e PAE dhe PAK dhe ndihmës akademik

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin

Realizimi i praktikës e përcaktuar në planin mësimor të programit bazohet në marrëveshjet që FE apo UT ka me institucione apo sipërmarrje të ndryshme duke angazhuar në këtë proces edhe PAE me planifikim ngarkese mësimore për ta.

DF ka në strukturën e tij edhe 1 personel ndihmës akademik që administron dokumentacionin e departamentit dhe mirëmban apo mbikëqyr laboratorët ku zhvillohen temat aplikative në

<p>e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>kontabilitet dhe finance, në rang fakulteti janë edhe 7 punonjës ndihmës akademik pranë departamenteve të tjera. Gjithashtu, koordinatori i programit që është përgjegjësi i departamentit është edhe personi përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve krahas pedagogeve të caktuar për monitorim gjate këtij procesi.</p> <p><i>Evidence nr.3.8. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.1 dhe 2).</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.13.Paketa e plote e bazës së dokumenteve të praktikës mësimore për programin MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3.7.CV e PAE dhe PAK</i></p> <p><i>Takim i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UT dhe në vendimin e Dekanatit të FE nr.6 date 19.4.2021, Përgjegjësi i njësisë bazë ka edhe në rolin e koordinatorit të programit, që aktualisht është Prof.Dr.D. K. Gjithashtu, koordinatori i programit organizon edhe praktikat profesionale të studentëve. Nga takimi me stafin akademik evidentuam diskutimet në mbledhjen e departamentit të problematikave lidhur me mësimdhënien, realizimin e praktikave dhe mbrojtjen e diplomave të prezantuara nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e brendshme e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.2.Vendim për emërimin e koordinatorit të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.24.Propozim për koordinatorin e programit të studimit</i></p> <p><i>Takim i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se njësia kryesore FE dhe njësia bazë DF përgjegjëse për këtë program studimit plotëson tërësisht kërkesat ligjore dhe standardet e kërkuara për këto njësi duke pasur kualifikimin e duhur akademik, shkencor dhe profesional që kërkon një program studimi i ciklit të dyte me fokus financën.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga institucioni, Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti Financës si njësi bazë e programit, dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe që janë jo vetëm në dosjen përmbledhëse të programit por edhe të arshivuara dhe të shpallura në website e këtyre njësive.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit Master i Shkencave në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Verifikim nga GVJ gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor që përfshin 15 lende i cili është i ndarë në strukturë në orë në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elementë këto matës të sistemit ECTS dhe përfshin një numër total prej 120 ECTS.</p> <p>Orët në auditor (1225 ore) dhe orët jashtë auditorit (1775 ore) janë ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në katër semestrat e dy viteve akademike.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca 3.1. Rregullore për organizimin e programit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</p>	<p>Marrja e informacionit për kriteret dhe procesin për tu regjistruar në këtë program, për studentet që po e zhvillojnë këtë program si dhe mundësia e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statutin e UT; • Rregullores së studimeve të UT; • Rregullores e programit MSH në “Finance”;

<p>ekuivalentimit të studimeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzime në nivel njësie kryesore apo baze; <p><i>Evidenca nr.1.2.rregullore e UT</i> <i>Evidenca nr.3.22.Broshura e Departamentit të Financës</i> <i>Evidenca nr.3.1. Rregullore e programit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit; • Viti/semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse; <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final.</p>

	<p>Përkatësisht, studenti vlerësohet në kufijtë 40% deri 50 % nga elementet gjate vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar. Vlerësimi gjate vitit në këto nivele i përgjigjet me se miri edhe angazhimit individual të studenteve në një program studimi të ciklit të dyte.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca 3.1. Rregullore për organizimin e programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (te tre viteve të fundit</i></p> <p><i>Verifikim nga vizita në sekretari të procesverbaleve të lendeve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DF u evidentua diskutimi dhe axhustimi programit në mënyre periodike në fillim të vitit brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës në përputhje me zhvillimet në tregun financiar e bankar që janë reflektuar dhe në programe të lendeve.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit dhe takimin me stafin që mbulon programin evidenton se ky program studimi është i plote me të gjithë elementet ligjor, strukturor duke qene në përputhje me objektivat formuese për një program studimi të ciklit të dyte me fokus financën. Bazuar ne përmbajtjen e programeve te lendeve gjykojmëse ato janë hartuar sipas kriterëve te përcaktuara dhe kane përmbajte trajtimin e njohurive me fokus objektin e lendes përkatëse ne funksion te karakterit formues te lendes.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi studimi të ciklit të dytë në fushën e Financës. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në programin Bachelor në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë teorike shkencore dhe aftësitë e studentëve në përputhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara. Këtë e shikojmë kryesisht në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës mësimore me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lëndet e fokusuar në objektin e tij që është financa, kontabiliteti menaxhimi financiar dhe i riskut në fusha apo sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Niveli i avancuar i njohurive formuese përkon edhe me cilësinë e studenteve në hyrje të këtij programi që gjate 3 viteve të fundit nota mesatare e tyre ka qene rreth 7.51 %.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca 3.1. Rregullore për organizimin e programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e financës, kontabilitetit dhe menaxhimit financiar edhe mundësinë për të realizuar kërkime shkencorë në sektorë të veçante të cilat ballafaqohen me natyra të ndryshme të aspektit financiar. Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të riskut.</p> <p>Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën mësimore të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor por edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika mësimore dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë</p>

	<p>të përgatitjes profesionale të studentëve. Lende të tilla me karakter teorike shkencor si “Ekonometri në Finance”, “Teoria Moderne e Investimeve” apo “Metodat e Kërkimit Shkencor në Finance” i paraprijnë lendeve vijuese me karakter formimi profesional dhe aplikativ në finance.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca 3.1. Rregullore për organizimin e programit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në finance, banke, menaxhim financiar apo risku. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa dhe menaxhimi financiar dhe i riskut në ekonomi. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>Përfshirja e 3 lendeve me zgjedhje në vitin e dytë të programit të studimit nga 6 të tilla të ofruara i jep një fleksibilitet dhe orientim me të qarte për studentet drejt tregut të punës. Hapja dhe zhvillimi gjate gjithë këtyre viteve i këtij programi studimi është bazuar edhe në studimin e tregu të punës me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit.</p> <p><i>Evidenca nr.3.11.SAnaliza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e Departamentit të Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit)</i></p>

<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="582 492 1364 1142"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi Msc. Fin</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>5%-10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50%- 60%</td> <td>60</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12%-20%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td> <td>10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>10%- 15%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca nr.3.8.Evidenca përmbledhëse e RVB, tabelat aneks (tabela nr.9)</i></p>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Msc. Fin		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi Msc. Fin																							
		Kredite	Përqindje																								
A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%																								
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%																								
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%																								
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%																								
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%																								
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve të lendeve si dhe nga takimi me stafin në institucion evidentohet përmbajtja cilësore e të gjithë elementeve të përcaktuar. Ky program ka nja historik të gjatë por që ne vijimësi ka përmirësuar programet e lendeve me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit në tregun financiar e bankar. Kjo u evidentua edhe në takimin që GVJ pati me stafin e këtij programi.</p> <p><i>Evidenca nr.3.3.Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit</i></p> <p><i>Takim i GVJ me stafin që mbulon programin</i></p>																										
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Programi MSH në “ Finance” i pajis studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me</p>																										

<p>garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së financës, bankave, menaxhimit financiar dhe të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet të natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca nr.3.11.Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e Departamentit të Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e gjatë të UT dhe FE si institucionet më të konsoliduar në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri dhe programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta.</p> <p>Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit financiar e bankar por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektorë reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë si në sistemin doganor dhe tatimor por edhe si financiere dhe menaxhere në sektorin e sipërmarrjes private.</p> <p><i>Evidenca nr.3.11.Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e Departamentit të Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.3..Dosja përmbledhëse e programit të studimit MSH në Financë (tabela nr.21)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet e lendeve (të tre viteve të fundit)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në analizën e programit të studimi, planit mësimor, përmbajtjes lëndore të tij, evidenton se ai është në përputhje me objektivat formuese me fokus financën dhe menaxhimin financiar e riskun dhe është njëkohësisht në nivelin e kualifikimit sipas</i></p>

	<i>Kuadrit kombëtar dhe European të Kualifikimeve dhe kompetencave në plotësim të kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Hapja e këtij programi për here të pare në vitin akademik 2010-2011 erdhi si rrjedhojë e reflektimit të zhvillimeve dinamike në ekonomi dhe sidomos në sektorin financiar. Programi synon tu japë studenteve krahas njohurive të gjera dhe me të thella në fushën e financave duke i bërë ata me konkurrues në tregun e punës. Në këtë kuadër, ky program studimi është bazuar në marrëdhëniet intensive të bashkëpunimit si me aktoret e brendshëm institucional dh të sipërmarrjes private, ashtu edhe me institucionet homologe jashtë vendit. në kuadër të bashkëpunimit intensiv edhe vete programi është përmirësuar në aspektin e trajtimeve teorike shkencore por edhe të nja procesi të suksesshëm mësimdhënieje dhe mësim nxënieje rrjedhojë e stafit të kualifikuar dhe nivelit të lartë të studenteve të regjistruar.</p> <p>Janë veprimtaritë e përbashkëta të UT, FE dhe DF me institucionet dhe sipërmarrjet private që kane ndikuar në përmirësimet jo vetëm të programit por edhe të angazhimit aktiv të studenteve të këtij programi në tregun e punës. Në shërbim të këtij qëllimi janë edhe konferencat e zhvilluara në rang Fakulteti por edhe nga Departamenti i Financës që gjate 5 viteve të fundit kanë qenë të përvitshme(përjashto periudhën e pandemisë). Edhe organizimi i disa workshopeve nga Departamenti i Financës ka ndihmuar në kuadër të zhvillimeve të reja në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca nr.2.33. Lista e marrëveshjeve ndërinstytucionale të bashkëpunimit në nivel FE UT,</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.3.11. Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e DF.2022</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.32. Konferenca të organizuara nga FE dhe DF</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies si në takimet që organizohen mes tyre dhe pedagogeve ashtu edhe nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara e të analizuar për ta në fund të semestrit nga NJSBC e FE, në këtë kontekst kane shërbyer edhe leksionet e hapura të organizuara nga njësia kryesore dhe ajo baze.</p> <p><i>Evidenca nr.3.11. Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e DF.2022</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me studentet e programit,</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes lëndore të syllabusve dhe nga takimi me stafin akademik të programit të studimit evidentuam që gjate viteve të fundit janë përmirësuar programet lëndore duke reflektuar zhvillimet në tregun financiar e bankar. Takimet me përfaqësues të institucioneve dhe sipërmarrjeve private dhe tryezat të rrumbullakëta me ta kane qene shtyse kryesore për këto ndryshime. Nga ana tjetër stafi akademik që zhvillon këtë program ka kualifikimin e duhur dhe eksperiencën e gjate si një garantues i përmirësimeve në programet lëndore të secilit prej tyre.</p> <p><i>Evidenca 3.7.CV e personelit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.23.. Konferenca të organizuara nga Fakulteti dhe Departamenti</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se njësia kryesore FE dhe ajo baze DF kane bere të mundur që nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të mund të përfshijnë aktivisht studentet në përmirësimin e programeve</i></p>

	<i>lëndore dhe si rrjedhim në marrjen e njohurive bashkëkohore në fushën e financës, menaxhimit dhe riskut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e tregut financiar, menaxhimit financiar dhe atë të riskut të cilat janë pjese e objektiveve madhore të këtij programi. Krahas strategjisë së zhvillimit të institucionit UT edhe në planin strategjik të këtij programi studimi (faqe 7) janë të përcaktuar qarte dhe në mënyrë të hollësishme objektivat e programit në dinamikën e tyre. Gjate 3 viteve të fundit janë organizuar 13 workshope ku mund të veçonim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • workshop mbi sfidat dhe zhvillimi i kurrikulës universitare dhe profesionale të kontabilitetit në sektorin publik; • workshop mbi Teknologjinë digjitale dhe etika në fushën e kontabilitetit dhe auditimit; <p><i>Evidenca nr. 1.4.Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028</i> <i>Evidenca nr. 3.2.Plani strategjik i programit të studimit MSH në Financë</i> <i>Evidenca nr. 3.3.Dosja përmbledhëse e programit të studimit</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit	<p>Gjate vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar na argumentuan axhustime në program sidomos me zhvillimin e modeleve aplikative gjate trajtimit të projekteve të kursit apo përdorimin e modeleve ekonometrike në laborator.</p> <p><i>Takim me stafin e programit gjate vizitës në institucion.</i></p>

<p>akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Për vetë specifikën e këtij programi i fokusuar në financë ai u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teorik e shkencore dhe aplikativ. Menaxhimi financiar dhe i riskut financiar, analiza e institucioneve financiare, optimizimi i investimeve etj, janë një fokus i gjere për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës tashme kanë një eksperience disa vjeçare edhe në organizimin e konferencave studentore duke u dhënë mundësi studenteve të përgatisin prezantime teorike shkencore edhe në fushën e menaxhimit të riskut. GVJ evidentoi dhe disa nga punimet përmbyllëse të programit të studimit (mikroteza) ku spikat trajtimi teorike shkencor nëpërmjet modelimeve ekonometrike me ate aplikative të fushës ku studentet janë të punësuar.</p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.32.. Konferenca të organizuara nga FE dhe DF</i></p> <p><i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Programi MSH në Financë mbështetet financiarisht nga buxheti i FE në kuadrin e institucionit publik. Nga ana tjetër Departamenti i Financës në përmbushje të aktiviteteve kërkimore shkencore ka pasur si burim financimi fondet e projekteve Erasmus +, projektet kërkimore ku janë të përfshirë stafi akademik si dhe mbështetje nga institucioni. Nga takimi në institucion u informuam që në dispozicion të Departamentit janë akorduar fonde për mbështetje të kërkimit shkencor dhe botimeve në dokumentet shtese të kërkuar nga GVJ për këtë problem është edhe dokumenti shtese i ardhur nga institucioni që evidenton këtë praktike mbështetje financiare nëpërmjet ribursimeve nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca nr.1.14.Programi i garantit për prezantimin e një punimi, kërkimi në konferenca ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Evidenca 2.19.dhe 2.20. Lista e aplikimeve dhe implementimeve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtarë të FE</i></p>

	<i>Evidenca shtese. Praktika e rimbursimit per stafin akademik</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe takimin me stafin akademik të programit evidenton garanton orientimin në fushën e studimit dhe kërkimit në sektorin financiar lidhur me menaxhimin financiar dhe atë të riskut.</i></p> <p><i>Ky proces gjen dhe mbështetjen financiare nga institucioni në mënyrë direkte dhe indirekte në funksion të kërkimit shkencor në këtë fushë dhe me gjere.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore. Bazuar në dosjen e aplikimit evidentohet se për periudhën 2024-2025 në kuadër të FE janë 45 aplikime për projekte në kuadër të thirrjeve ndërkombëtare dhe 24 në kuadër të thirrjeve kombëtare UT dhe FE krahas thirrjes për projekte mbështet financiarisht edhe financimet përmes sigurimit të fondeve publike të dhëna nga AKKSHI apo AKFAL për projekte rajonale dhe ndërkombëtare. Në kuadër të DF stafi akademik gjate periudhës 2020-2024 është përfshirë në 32 projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare</p> <p><i>Evidenca 2.19.dhe 2.20. Lista e aplikimeve dhe implementimeve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtarë të FE</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3.12.Tabele përmbledhëse e projekteve të personelit akademik efektiv të DF 2020-2024</i></p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>FE si njësi kryesore dhe Departamenti i Financës si njësi bazë zhvillimit të programit është aktiv në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Në kuadër të DF stafi akademik gjate periudhës 2020-2024 është përfshirë në 32 projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Një drejtim i rëndësishëm lidhur me kualifikimin dhe angazhimin e stafit akademik janë edhe publikimet gjate viteve të fundit të tij. Bazuar në listën e publikimeve evidentohet që gjate dy viteve akademike të fundit (2022-2023 dhe 2023-2024) janë 56 anëtarë të stafit akademik (PAE) që kane publikuar punime shkencore në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga ana tjetër edhe studentët janë përfshire në kuadër të disa prej projekteve të DF por dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në realizimin e studimeve të përbashkëta. Gjatë periudhës së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës, shikohet edhe angazhimi i studenteve në përgatitjen e punimeve shkencore.</p> <p><i>Evidenca 2.19.dhe 2.20. Lista e aplikimeve dhe implementimeve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtarë të FE</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3.12.Tabele përmbledhëse e projekteve të personelit akademik efektiv të DF 2020-2024</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca 3.18.Lista e publikimeve shkencore dhe konferencave shkencore nga PAE i DF</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.32.. Konferenca të organizuara nga FE dhe Departamenti</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme. FE dhe DF gjithashtu kane organizuar gjate viteve të fundit konferenca shkencore, simpoziume shkencore, konferenca studentore dhe workshop-e të përvitshme me një angazhim të kënaqshëm të stafit akademik dhe studenteve.</p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.2.32.. Konferenca të organizuara nga Fakulteti dhe Departamenti i Financës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Studentet e regjistruar në këtë program studimi janë kryesisht studente që kane mbaruar po në FE programin Bachelor në financë si dhe të punësuar në institucione apo sipërmarrje private kryesisht në sektorin e ekonomisë. Në këtë kontekst programi arrin të përcjellë jo vetëm njohuritë e thelluara teorike shkencore në fushën e financës por edhe aspektin aplikativ të tyre me synim rritjen e konkurrueshmërisë së studenteve të diplomuar në tregun e punës.</p> <p>Për këtë arsye, FE dhe DF kane organizuar mjaft veprimtari të përbashkëta me aktoret e tregut të punës me qëllim të dyfishtë, të prezantimit të kualifikimit nga studentet dhe tërheqjes së mendimit bashkëkohor nga aktoret e tregut të punës. Edhe vete përgatitja e punimit përmbysës të programit (mikroteza) i ka shërbyer aftësisht jo vetëm shkencor por edhe aplikativ në sektorin ku studentet janë të punësuar. Mësimi që zhvillohet në orarin e pasdites është një lehtësim i studenteve që janë njëkohësisht edhe të punësuar.</p> <p><i>Evidenca 2.19.dhe 2.20. Lista e aplikimeve dhe implementimeve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare të FE</i></p> <p><i>Evidenca nr. 3.12.Tabele përmbledhëse e projekteve të personelit akademik efektiv të DF 2020-2024</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.11.Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e DF.2022</i></p> <p><i>Vizita e GVJ dhe takimi me studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>DF në traditën e vet mban lidhje të vazhdueshme dhe organizon veprimtari në fushën e financës dhe kontabilitetit (edhe në bashkëpunim me Departamentin e Kontabilitetit) me aktore të tregut të punës por edhe me shoqata profesionale dhe institucione rregullatorë në ndihmë të trajnimit të vazhdueshëm të studenteve në fushën profesionale. Kjo është realizuar krahas realizimit të praktikës mësimore të studenteve pranë tyre por edhe nëpërmjet workshope-ve dhe tryezave të rrumbullakëta. Këtë GVJ e evidentoi edhe në takimin me studentet e programit të studimit</p>

	<p><i>Evidenca nr.3.17. Workshope të organizuara nga Departamenti i Financës</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.11.Analiza e tregut të punës dhe Alumnit për studentet e DF.2022</i></p> <p><i>Vizita e GVJ dhe takimi me studentet</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Duke analizuar programin e studimit dhe veçanërisht planin mësimor të tij, vërejmë se ai i shërben formimit të profesionisteve të kualifikuar në fushën e financës në profesione tashme të rregulluara në Shqipëri si, këshillues financiar, kontabilist të miratuar, ekspert kontabël, vlerësues të pasurive të patundshme etj.</p> <p>Lende të tilla të programit si “Drejtim Financiar i Avancuar”, Kontabilitet Financiar i Avancuar”, Drejtim Risku” apo “drejtim i Pasurive të Paluajtshme” kane karakter jo vetëm teorik por edhe aplikativ në funksion të profesioneve të përmendura me lart. Staffi akademik që zhvillon këtë program tashme i konsoliduar prej vitesh ka jo vetëm kualifikimet teorike shkencore por edhe atë aplikative duke kontribuar në rritjen e nivelit profesional të studenteve të programit.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB(tabela 1, 2,3 dhe 4)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dosjen e plote të aplikimit të institucionit evidentimin nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me stafin dhe studentet e programit vlerëson se ky program i ciklit të dyte në financë plotëson tiparet e një programi që ofron njohuri të thelluara teorike shkencore në fushën e financës siç edhe ofrojnë programe të tilla homologe në vendet e tjera.</i></p> <p><i>Njëkohësisht programi i studimit MSH në financë jep mundësin e realizimin me sukses të kërkimit shkencor në fushën e financës, menaxhimit financiar dhe të riskut.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “Financë” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në rregulloren e vete këtij programi, në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 15 lëndë, ku janë parashikuar kontrole të dijeve në vazhdimësi dhe në fund të semestrit, si testet e ndërmjetime, detyra kursi, provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës (mikroteza).</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • 40 % provim i ndërmjetëm dhe detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit;

	<ul style="list-style-type: none"> • 50% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit; <p>Kjo mënyrë vlerësimi ku vlerësimi i vazhduar shkon në shumicën e lendeve deri në 50 % (ne disa prej lendeve edhe 40 %) reflekton edhe natyrën e një programi të ciklit të dytë ku studenti është i angazhuar maksimalisht gjate gjithë vitit akademik. Gjithashtu, gjate zhvillimit të lendeve aplikative zhvillohen edhe leksione të hapura me profesioniste sidomos në kontabilitet dhe menaxhim risku financiar. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.. Rregullorja e programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB(tabela 13 dhe 15)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies (shih dhe vlerësimet më lart). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysht në disa raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kërkues e shkencor të mësim nxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mire mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. Për stafin e ri akademik janë organizuar edhe trajnime specifike metodologjike.</p> <p><i>Evidenca nr.3.1.. Rregullorja e programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p>

	<p><i>Evidence nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB(tabela 13 dhe 15)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.21. Lista e e shkëmbimeve në kuadër të \ERASMUS për stafin akademik (2021-2025) të stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca nr.,.3.15.Metoda novative të mësimdhënies</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënëit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e Departamentit të Financës rezulton se FE i UT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti dhe Fakulteti me ekspertë të fushës së pedagogjisë, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies në buxhetin e FE të UT planifikohen fonde për përmirësimin e bazës laboratorike, shtimin e fondit të librave etj. Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom.</p> <p><i>Evidenca 2.21. Lista e e shkëmbimeve në kuadër të \ERASMUS për stafin akademik (2021-2025) të stafit akademik</i></p> <p><i>Evidenca nr.,.3.15.Metoda novative të mësimdhënies</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36.Plani financiar i programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.17. Informacion për garantin: Plani buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm FEUT.</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional të lartë në fushën e Financës, kontabilitetit si dhe menaxhimit të riskut financiar e të të biznesit. Në këtë kontekst do vlerësonim dhe nivelin e lartë profesional të tyre rrjedhoje e një stafi të</p>

<p>interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>qëndrueshëm dhe eksperiencës të gjate të tyre. Kështu në vitin akademik 2024-2025 nga 31 PAE të angazhuar në këtë program 18 prej tyre apo 58 % janë të kategorisë “Profesor” dhe pjesa tjetër kane gradën shkencore “Doktor” ose janë në proces për fitimin e kësaj grade.</p> <p><i>Evidenca nr.3.1.. Rregullorja e programit të studimit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.8. Përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela 7)</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore dhe modeleve ekonometrike. E tillë konsiderohet rritja e orëve të aplikimit praktik në lëndët e e “Ekonometrisë në Financë” apo “Metodat e kërkimit shkencor në Finance” u evidentuan nga takimi me studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në</p>	<p>Institucioni bazuar në kuadrin ligjor nënligjor dhe regullativ për arsimin e larte, ka ngritur dhe operojnë strukturat e duhura që</p>




<p>nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>monitorojnë, analizojnë, ndihmojnë dhe këshillojnë në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto struktura janë në nivel institucional si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) që realizojnë funksionet e mësipërme. Këto struktura monitoruese të cilësisë të procesit mësimor e ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në rregulloret përkatëse ku janë të detajuara gjithë proceset dhe procedurat që ato zbatojnë për të përmbushur objektivat e tyre.</p> <p>Edhe në rang njësie kryesore, FE është ngritur NJSBC e cila monitoron dhe analizon cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në Fakultet. Kjo njësi bashkëpunon me njësinë baze DF në realizimin e funksionit të saj. GVJ krahas dokumentacionit të aplikimit ku është njohur me veprimtarinë e kësaj njësie të FE, organizoi edhe takimin me anëtarët e saj ku u diskutua me gjere rreth rolit të saj në procesin mësimor në programin që vlerësojmë. Bazuar në rregulloren e NJSBC, GVJ evidentoi krahas rolit të rëndësishëm në këtë proces që luan vete DF si njësi baze, kjo njësi përdor mekanizma të monitorimit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimeve në auditor për stafin akademi; • vlerësimin e pedagogut dhe lendes nga studentet kryesisht nëpërmjet pyetësorëve anonin; • takim i drejtpërdrejtë i NJSBC me studentet e programit nëpërmjet focus grup-it; <p><i>Evidenca nr.1.16.Rregullore për organizimin dhe funksionimin e KPSSC</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.17. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.18.Paketa për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.30.Plani i veprimtarisë së NJSBC (2024-2028)</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.25.Te dhëna mbi veprimtarinë e NJSBC dhe raportimi në FE</i></p> <p><i>Evidenca shtese kërkuar nga GVJ: Mbi rezultatet e përfituara nga paketa e instrumenteve të cilësisë</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni UT dhe njësia kryesore FE dhe ajo baze DF nëpërmjet formave të mësimdhënies, transmetimit të</i></p>



	<i>dijeve bashkëkohore dhe risive metodologjike në këtë proces realizojnë praktikën me të mirë me fokus studentin duke garantuar rezultatet pozitive në standardin e cilësisë. Institucioni UT dhe njësi kryesore FE kanë ngritur dhe operojnë strukturat monitoruese të realizimit të cilësisë në mësimdhënie..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UT), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë) dhe rregulloren e këtij programi si dhe në paketen e zhvillimit të provimit. Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuarat mënyrat e testimit dhe e vlerësimit të dijeve jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1. Rregullore e programit MSH në Financë</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e	<p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te;

shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<ul style="list-style-type: none"> • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre; • Bashkëbisedimit mes tyre dhe pedagogut në orën e parë të mësimit; <p><i>Vizita në institucion në takimin me studentet dhe stafin</i></p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidenca nr.3.1. Rregullore e programit MSH në Finance</i> <i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i> <i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i> <i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni, UT, njësia kryesore FE dhe ajo baze DF kane të plotësuara gjithë bazën rregullative të procesit të vlerësimit të dijeve të studenteve të programit të cilat garantojnë vlerësimin e bazuar në merite.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të dyte të Kursit të I- të të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmblyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të

<p>vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>këtyre lëndëve vlerësohen me 50% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë 50 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>Evidenca nr.3.1. Rregullore e programit MSH në Finance</i> <i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i> <i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i> <i>Vizita në institucion e GVJ pranë sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitet e fundit UT dhe FE ka ndërmarrë iniciativë dhe ka aplikuar edhe me një pjese të lendeve të këtij programi sistemin elektronik të testimit në disa lëndë (<i>Projekti clean score</i>).</p> <p><i>Evidenca nr.3.1. Rregullore e programit MSH në Finance</i> <i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i> <i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i> <i>Vizita në institucion e GVJ pranë sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca nr. 1.34. Marrëveshje bashkëpunimi mes AADF dhe UT për programin Clean Score) dhe relacioni përkatës me shembull vlerësimi</i> <i>Evidenca nr. 3.23. Template flete cleanscor provimi në një nga lendet e programit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e testeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve Departamenti Financës, bazuar në rregulloret përkatëse, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri</p>

	<p>është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Financës.</p> <p><i>Vizite e GVJ në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi me 40% deri 50 % të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj.</p> <p><i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ pranë sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë kryesore dhe bazë, Departamenti Financës monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. GVJ gjate vizitës në institucion (që koencidoi me periudhën e sezonit të provimeve të vjeshtës) evidentoi zhvillimin e një procesi testimi të lëndës ku zbatoheshin rregullat e përcaktuara në këtë proces.</p> <p>Institucioni prezanton modelin e softwarit si një program antiplagjaturë që përdoret kryesisht për punimet e doktoraturave. Për të minimizuar plagjaturën, nga takimi me stafin e departamentit, u evidentua rëndësia që i jepej punimit të mikrotezes, të bazuara në raste studimore si dhe deklarimi i autorësisë nga ana e studentit në punimin e tij përmbyllës nëpërmjet një deklaratë individuale. GVJ evidentoi plotësimin e kësaj deklaratë nga studentit.</p>

	<p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.6. Kodi i etikes i UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14. Format mikroteze dhe formular vlerësimi për programin MSH (deklarata e studentit)</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ pranë sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testimeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve, në nenet 46,47,48 dhe 49 të rregullores se UT përcaktohet procedura e vlerësimit të studenteve.</p> <p>Në të përcaktohet se përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 14 ditëve nga zhvillimi i tij përmes platformës e -student dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij brenda 2 ditëve nga shpallja e tyre. Pedagogu përcakton brenda kësaj periudhe orarin për takimin me studentet që kane reklamim mbi vlerësimin dhe vetëm pas këtij procesi rezultati gjenerohet në sistem. në takimin me studentet GVJ evidentoi këtë procedure.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.19. Paketa e plote e formateve dhe procedurave të zhvillimit të procesit të provimit në DF</i></p> <p><i>Evidenca nr. 1.23 dhe 1.24.Manual i sistemit E-student per studentet dhe pedagoget.</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me studentet</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin.</p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me studentet</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	<p>Praktikat e ankimimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër, ndërsa nuk ka pasur të tilla për studentët e këtij programi. Por, në rastet e evidentuara,</p>

Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund.			
	<i>Vizita në institucion dhe takimi me pedagogoet dhe studentet</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ evidenton se institucioni realizon një vlerësim të drejte, transparent, bazuar në merite dhe me mundësi të studentit për të bërë vlerësimin anonim për pedagogun dhe lenden. Mbështetur në programet lëndore por edhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet u evidentua që pesha e konsiderueshme e vlerësimit të vazhduar është në nivelin e 50 % të njohurive të marra.</i></p> <p><i>Gjithashtu, procedura e realizimit të vlerësimit të dijeve u jep mundësi studenteve të njihen me vlerësimin dhe është transparente në rast të reklamimit prej tyre të vlerësimit brenda periudhës së caktuar në rregulloren e programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Finance, ku FE i UT tashme ka një historik dhe eksperience sa pozitive aq edhe të gjate. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim fillimisht të koncepteve bazë të financës, kontabilitetit dhe atë të riskut që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës por në atë të menaxhimit, ekonomiks etj.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e menaxhimit të riskut. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e</p>

	<p>aplikimeve të programeve në financë dhe menaxhim e riskut bankar të sigurimeve, tregjeve financiare etj. Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën mësimore të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik e shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezes që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e financës, drejtimin financiar dhe atë të riskut për në sektorin e ekonomisë. Lendet “Metodat e Kërkimit Shkencor në Finance”, Ekonometri në Finance”, Drejtim Risku ” apo “Teoria Moderne e Investimeve” të gërshtuara me aplikimet e rasteve studimore zhvillojnë aftësi të veçanta për një Drejtues financiar apo të riskut që formohet me një baze të shëndoshë matematikore dhe ekonometrike. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në lëndët që bazohen në modelime dhe programe informatike të aplikuara në këtë fushë. Gjithashtu eksperiencia e marre nga stafi akademik i programit nëpërmjet mobiliteteve pranë institucioneve partnere jashtë vendi kontribuon me shume në këtë drejtim.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.21. Lista e shkëmbimeve të stafit akademik në kuadër të ERASMUS-it</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej në një seance me vete mes pedagogut dhe studentit mbi realizimin e programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të</p>

<p>lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>semestrit). Edhe në vete programin e lendes parashikohet një përmbledhje e njohurive të marra gjate zhvillimit të lendes. Opinioni i studenteve ishte shume pozitiv mbi zhvillimin e kësaj seance.</p> <p><i>Evidenca nr.3.4.Plani mësimor i programit të studimit MSH në Finance</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit MSH në financë kombinon me se miri trajtimet e thelluara teorike shkencore me atë aplikative me qellim që të përmbushë objektivin e nje konkureshmerise në tregun e punës. Lendet që zhvillohen në semestrin e pare janë kryesisht teorike shkencore (“Metodat e Kërkimit Shkencor në Finance”, Ekonometri në Finance”, Drejtim Risku” apo “Teoria Moderne e Investimeve”) të cilat plotësohen në vijim me njohuri të thelluara në financë dhe tregun financiar që kane një pjese të rëndësishme të tyre aplikimet praktike dhe rastet studimore.</p> <p>Në takimin me stafin akademik të programit u evidentuan dhe pune në fokus grup me studentet gjate përgatitjes dhe prezantimit të detyrave të kursit si metode e frytshme për pune të pavarur nga studentet. Studentet evidentuan përdorimin e bazës laboratorike të FE dhe DF gjate realizimit të punimit të mikrotezes si një mundësi e mire për konsultim shtese me udhëheqësin e punimit.</p> <p><i>Evidenca nr.3.7. CV e stafit akademik të programit</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5. Programet mësimore të lendeve 2024-2025</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve ERASMUS, apo gjatë angazhimit në projekte. Mbështetur ne dokumentacion evidentohet edhe realizimi i</p>

<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>leksioneve të hapura me staf akademik të fushës apo specialiste të saj.</p> <p><i>Evidenca nr.2.21. dhe 2.22. Lista e shkëmbimeve në kuadër të ERASMUS -it për stafin akademik dhe studentet. leksione të hapura Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni UT, njësia kryesore FE dhe ajo baze DF nxisin studentet në zhvillimin e ideve inovative në forma dhe mënyra të larmishme kryesisht në angazhim të tyre në kërkimin shkencor. Në këtë kuadër në një sere projektesh që ka institucioni apo veprimtarive shkencore studentet janë pjese e tyre.</p> <p>Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjate realizimit të praktikës. Bazuar në informacionin shtese që kërkoi për këtë qellim GVJ gjate vizitës në institucion u evidentua gjithashtu raste të mbështetjes nga institucionit të iniciativave të studenteve në kërkime shkencore.</p> <p><i>Evidenca shtese: Mbështetja e studenteve në aktivitete kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 2.19.Lista e aplikimeve dhe implementimeve të projekteve ndërkombëtare FE UT</i></p> <p><i>Evidenca nr. 2.22.Lista e shkëmbimeve në kuadër të ERASMUS për studentet (2021-2025)</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takime me stafin dhe studentet</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton rolin aktiv të studenteve të programit që rrit me tej garancinë e aftësive krijuese dhe zbatuese të tyre duke përligjur njohuritë e thelluara shkencore të marra dhe aplikimin e tyre jo vetëm në veprimtaritë e organizuara nga institucioni por dhe në tregun e punës ku ata janë të angazhuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e UT (neni 60; 61 dhe 62), në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në rregulloren e diplomimit për të tre ciklet e studimit në UT. Ky proces është me i detajuar edhe në rregulloren e vete programit të studimit (neni 22 dhe neni 23). Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Nga takimi me stafin akademik të programit GVJ evidentoi diskutimin në DF të procesit të caktimit të pedagogut udhëheqës për punimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Financës, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në Departamentin e Financës përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Temat e punimeve të mikrotezes janë në fushën e financës, menaxhimit financiar dhe riskut që përbejnë dhe boshtin e njohurive karakterizuese të këtij programi studimi. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. GVJ evidentoi se udhëheqësit e punimeve të</p>

	<p>diplomës për studentet e këtij programi studimi ishin të kategorisë “Profesor” dhe “Doktor” që përkon me nivelin e studenteve të një programi të ciklit të dytë Master.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Financë.</i></p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti. <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të këtij programi që kanë përfunduar programin, (pasi studentët e këtij programi me të cilët GVJ u takua ende nuk e kanë përmbyllur programin). GVJ evidentoi dhe procesverbalin e vlerësimit përfundimtar të studenteve.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Takim me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti dhe të miratuar nga udhëheqësi i caktuar, Departamenti i Financës miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli</p>

<p>Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Në përgjithësi periudha e përgatitjes së punimit të diplomës përkon me kryerjen e praktikës mësimore. Kjo bën të mundur që për pjesën aplikative apo përpunues të të dhënave studenti dhe udhëheqësi i diplomës të bashkëpunojnë në ambientet e FE dhe përkatësisht në laboratorët e ngritur në FE.</p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të pare, të dyte dhe të trete të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14. Forma e mikrotezes dhe formular vlerësimi për programin MSH.</i></p> <p><i>Takim me stafin, studentet gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. GVJ vizitoi këto ambiente dhe evidentoi aksesin që kane studentet në përdorimin e pajisjeve laboratorike në përgatitjen e punimit të diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të pare, të dyte dhe të trete të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14. Forma e mikrotezes dhe formular vlerësimi për programin MSH.</i></p> <p><i>Takim me stafin, studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare. Studenti krahas dy kopjeve të punimit që dorëzon paraprakisht, ditën e mbrojtjes bën një prezantim 15 deri 20 minuta në power point për pikat kryesore të punimit. Komisioni krahas vlerësimit të udhëheqësit, dhe vlerësimit të punimit si dhe aftësive prezantuese të studentit bën pyetjet rreth punimit për të bere një vlerësim me të sakte. Vlerësimi evidentohet në procesverbalin e posaçëm të diplomimit me</p>

	<p>note. Ky vlerësim u behet e njohur studenteve në përfundim të mbrojtjes se realizuar prej tyre.</p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të pare, të dyte dhe të trete të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14. Forma e mikrotezes dhe formular vlerësimi për programin MSH.</i></p> <p><i>Takim me stafin, studentet gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2023-2024. Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit sapo ai bën edhe kërkesën përkatëse. Në të njëjtën kohë bën edhe tërheqjen e diplomës dhe suplementin e saj.</p> <p><i>Evidenca nr.1.8.Rregullore për diplomimin e ciklit të pare, të dyte dhe të trete të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Finance.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14. Forma e mikrotezes dhe formular vlerësimi për programin MSH.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.6. Formati i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës për programin MSH në Finance.</i></p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet gjate vizitës në institucion</i></p> <p><i>Takim në sekretarinë mësimore të institucionit</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në FE të UT rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen krahas regjistrave përkatës me informacionin e matrikullimit edhe në sistemin informativ të institucionit. Sekretaria mësimore disponon çdo informacion zyrtare lidhur me kërkesa të mundshme të studenteve të diplomuar me pare.</p> <p><i>Evidenca nr.3.6. Formati i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës për programin MSH në Finance.</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.2.6.Rregullore e degës se sekretarisë mësimore të FE</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.7. Sistemi i arkives FE</i></p> <p><i>Vizite e GVJ pranë sekretarisë mësimore të FE</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni ka një procedure të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentëve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Procesi i përmbylljes së detyrimeve të studenteve bazohet në rregulloren e përgjithshme të UT dhe në rregulloren e vetë programit të studimit.</i></p> <p><i>Në mënyrë më të detajuar institucioni ka hartuar edhe dhe e specifikuar me qarte në rregulloren e diplomimit për të tre ciklet e studimit gjithë këtë proces të rëndësishëm të përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës. GVJ evidentoi këtë proces edhe nga takimi me stafin akademik të programit, studentet dhe stafin e sekretarisë mësimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe	N / A

stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Departamenti i Financës përbën njësinë bazë përgjegjëse për projektimin, zhvillimin dhe zbatimin e këtij programi studimi. Mësimdhënia mbulohet kryesisht nga stafi akademik i këtij departamenti, ndërsa, në funksion të përmbajtjes dhe kërkesave specifike të lëndëve, angazhohen edhe pedagogë të jashtëm (PAK). Nga analiza e dokumentacionit rezultoi se përgjatë viteve akademike 2022–2025, programi i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Financë" është mbështetur në mënyrë të qëndrueshme nga një strukturë akademike e mirëorganizuar. Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat në tabelat përmbledhëse, të cilat japin një panoramë të qartë mbi përfshirjen e stafit të brendshëm (PAE) dhe atij të jashtëm (PAK). Për 3 vitet e fundit akademike, të dhënat lidhur me stafin e përfshirë në mësimdhënie për këtë program studimi janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	8	1	8	1	7	
Prof. Asoc.	9		12		11	
Dr/Phd	3	2	2	2	3	3
Dr/Phd në proces	5		6	1	5	1
Msc	5	3	7	7	5	5
Gjithsej	30	6	35	11	31	9

Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi "Master i Shkencave", angazhohen edhe staf akademik me Msc, në kundërshtim me përcaktimet ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), ku personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

Pa llogaritur stafin akademik që është në proces doktoreture stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie (në %) me Msc në programin e studimit sipas viteve akademike është si vijon:

	<p>Për vitin akademik 2022 – 2023 – 22 % e stafit është me Msc; Për vitin akademik 2023 – 2024 – 30 % e stafit është me Msc; Për vitin akademik 2024 – 2025 – 25 % e stafit është me Msc;</p> <p>Bazuar edhe ne tabelat e korrigjuara qe institucioni dërgoi se bashku me komentet e draft RVJ evidentohet përsëri ndonëse ne përqindje me te ulet angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik që zotëron vetëm gradën “Master i Shkencave (MSc).</p> <p>Nga shqyrtimi i ngarkesës se stafit akademik në këtë program por edhe nga takimi dhe diskutimi që GVJ realizoi me ta u evidentua që pedagogët me Master angazhoheshin në seminare apo punët laboratorike.</p> <p><i>GVJ rekomandon</i> që, për realizimin e programit të studimit MSH. Në “Financë”, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”, për vitet akademike 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.7 CV-të e stafit PAE dhe PAK të angazhuar në realizimin e programit të studimit “Master Shkencor në Financë” gjatë periudhës 2021–2025.</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Memo:Komente mbi Draft RVJ nga institucioni</i></p>								
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore të pasqyruara në tabelat përmbledhëse të RVB-së, rezulton se në vitin akademik 2024–2025, pedagogët me angazhim të plotë PAE mbulojnë <u>78%</u> të ngarkesës mësimore krahasuar me PAK</p> <table border="1" data-bbox="600 1608 1362 1760"> <thead> <tr> <th><i>Raporti</i></th> <th><i>2022-2023</i></th> <th><i>2023-2024</i></th> <th><i>2024-2025</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ngarkesa e PAE/PAK</td> <td>84%/16%</td> <td>76%/24%</td> <td>78%/22%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”, për vitet akademike 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p>	<i>Raporti</i>	<i>2022-2023</i>	<i>2023-2024</i>	<i>2024-2025</i>	Ngarkesa e PAE/PAK	84%/16%	76%/24%	78%/22%
<i>Raporti</i>	<i>2022-2023</i>	<i>2023-2024</i>	<i>2024-2025</i>						
Ngarkesa e PAE/PAK	84%/16%	76%/24%	78%/22%						

	<p><i>Evidenca 3.7 CV-të e stafit PAE dhe PAK të angazhuar në realizimin e programit të studimit "Master Shkencor në Financë" gjatë periudhës 2021–2025.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në bazë të të dhënave të përfshira në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të institucionit, si dhe dokumentacionit shoqëruar të dorëzuar për qëllime akreditimi, evidentohet një vazhdimësi e qëndrueshme në angazhimin e personelit akademik përgjatë viteve të fundit në këtë program. Kontrolli i ushtruar nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNJ) konfirmon se stafi PAE dhe PAK është i punësuar me kontrata të rregullta pune, ku janë të përcaktuara qartë detyrimet e ndërsjella, përfshirë mbulimin e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.11 Tabelat përmbledhëse të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, FEUT 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.12 Model kontrate për personelin akademik me kohë të plotë, FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.13 Model kontrate për personelin akademik me kohë të pjesshme, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Model inventari dhe përditësimi të dosjes së personelit akademik efektiv FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret specifike përcaktohen nga Departamenti përkatës në përputhje me nevojat për zgjerimin e kapaciteteve akademike. Ato përfshijnë njohuritë dhe zhvillimin e lëndëve për të cilat realizohet rekrutimi, si dhe preferencat për kualifikime jashtë vendit në fushën përkatëse. Drejtuesi i njësisë përkatëse i përcjell këto kriteret Rektorit, i cili vijon procedurën e përzgjedhjes.</p> <p>Ky proces zhvillohet në dy faza: <i>së pari</i>, verifikimi i dokumentacionit të aplikantëve, dhe <i>së dyti</i>, intervistimi i kandidatëve që kualifikohen pas shqyrtimit të dosjeve. Komisioni i përzgjedhjes harton vendimin përfundimtar, duke renditur kandidatët sipas pikëve të grumbulluara. Lista e përzgjedhur i dorëzohet titullarit të njësisë kryesore të FEUT, i cili e përcjell tek Rektori i UT për miratimin final të fituesit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.15 Procedura e rekrutimit të personelit akademik Model procedure për komision ad-hoc rekrutimi, FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës, si njësi përgjegjëse për programin e studimit të Master i Shkencave në “Financë”, përfshin gjithashtu personel ndihmës akademik që mbështet në mënyrë aktive zhvillimin e procesit mësimor. Ky staf kontribuon funksionalisht në laboratorë dhe në mjedise të tjera të studentëve, duke garantuar një koordinim të efektshëm të veprimtarive mësimore në përputhje me nevojat e programit. Angazhimi dhe puna e tij u konfirmuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion, duke vërtetuar përfshirjen e plotë dhe funksionimin e personelit ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”, për vitet akademikë 2021-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e brendshme e punës Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT”, miratuar më 27.01.2022, neni 10 parashikon krijimin e Drejtorisë së Shërbimit të Brendshëm (ish-Drejtoria e Burimeve Njerëzore), e cila në nivel institucional menaxhon edhe procedurat e punësimit të personelit akademik dhe joakademik. Këto funksione realizohen nga sektori i Burimeve Njerëzore, një nga strukturat e kësaj Drejtorie, përgjegjës gjithashtu për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Në nivelin e FEUT, funksionon Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, e cila administron procesin e rekrutimit të stafit akademik dhe monitoron dokumentacionin përkatës, duke pasuruar dhe përditësuar dosjet në kohë reale. Takimi me drejtuesen e kësaj Dega dhe shqyrtimi i dokumentacionit treguan se ajo është përgjegjëse për administrimin e plotë të të gjitha procedurave që lidhen me stafin e angazhuar në fakultet, përfshirë ruajtjen dhe përditësimin vjetor të të dhënave të personelit efektiv dhe atij të angazhuar me kontratë. Procesi i</p>

	<p>rekrutimit zhvillohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Departamenti i Financës , të cilat në rastin e programit të studimit fokusohen në njohuritë dhe përvojën e kandidatit në fushën përkatëse, si dhe në kualifikimet akademike të fituara brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Pas shpalljes së pozicionit, aplikimet shqyrtohen nga personeli përgjegjës dhe kandidatët që përmbushin kriteret kalojnë në fazën e intervistës. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek të gjitha fazat e procesit, duke garantuar transparencën dhe respektimin e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga shqyrtimi i dy dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, si për pedagogët e brendshëm (PAE), ashtu edhe për ata të jashtëm (PAK), nuk u evidentuan mangësi në dokumentacion. Dosjet e stafit të angazhuar në programin e studimit përfshijnë dokumentacionin standard, si kontrata e punës, diplomat dhe listat e notave të noterizuara për studimet universitare, master dhe doktoraturë, CV-të, si dhe të dhëna të detajuara mbi kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari akademike dhe kërkimore, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.11 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT.</i></p> <p><i>S Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Sistemi i arkivës FEUT Manual përdorimi.</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Model inventari dhe përditësimi të dosjes së personelit akademik efektiv FEUT</i></p> <p><i>Shqyrtimi i dosjeve të personelit gjatë vizitës në institucion nga GVJ</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve</p>	<p>FEUT ka vendosur një sërë bashkëpunimesh me biznese dhe aktorë të sektorit privat, të cilat mbështesin zhvillimin e leksioneve të hapura dhe krijimin e mundësive për praktikë profesionale për studentët. Stafi akademik i programit luan një rol aktiv në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e këtij procesi pranë institucioneve partnere. Praktika profesionale përbën një komponent thelbësor të programit në fushën e financës dhe realizohet në mënyrë të organizuar dhe të mirëstrukturuar. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vërejti se stafit i delegohen detyra konkrete për të ndjekur progresin e studentëve gjatë praktikës</p>

<p>në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>dhe për të udhëhequr procesin e hartimit të diplomës, duke siguruar një eksperiencë të integruar dhe të kontrolluar profesionalisht.</p> <p><i>Evidenca 2.33 Lista e marrëveshjeve ndër-institucionale kombëtare e ndërkombëtare me FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.13 Paketa e plotë e bazës së dokumenteve të praktikës mësimore për programin e studimit "Master i Shkencave."</i></p> <p><i>Evidenca 3.14 Format mikroteze dhe formular vlerësimi mikroteze për programin e studimit "Master i Shkencave".</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Financë", u theksua angazhimi i vazhdueshëm i pedagogëve në mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Njëkohësisht, u vlerësua edhe mbështetja e ofruar nga ta në përgatitjen e raportit përfundimtar që studentët dorëzojnë pas përmbylljes së praktikës.</p> <p><i>Evidenca 3.13 Paketa e plotë e bazës së dokumenteve të praktikës mësimore për programin e studimit "Master i Shkencave."</i></p> <p><i>Vizita në institucion nga GVJ</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se stafi akademik i këtij programi ka ruajtur një qëndrueshmëri të dukshme në përbërje dhe angazhim. Ky staf merr pjesë në mënyrë aktive si në zhvillimin e procesit mësimor, ashtu edhe në ndjekjen e praktikës profesionale të studentëve.</i></p> <p><i>Gjithashtu, ai ofron mbështetje konkrete për përgatitjen e raporteve përfundimtare dhe për udhëheqjen e temave të diplomës. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet partnere kanë krijuar kushtet e nevojshme për realizimin e praktikës në mënyrë funksionale dhe të suksesshme.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon se për realizimin e programit të studimit në proces vlerësimi, Institucioni duhet të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe në konstatimet gjatë vizitës në terren, në kuadër të vlerësimit të infrastrukturës së Fakultetit të Ekonomisë të UT, GVJ vëren se Departamenti i Financës operon në ambiente që përmbushin standardet për zhvillimin normal të programit. Procesi mësimor zhvillohet në godinat A 3 (tre) kate dhe B 6 (gjashtë) kate, të cilat janë të pajisura me salla leksionesh dhe auditorë seminari. Po ashtu, janë të disponueshme hapësira funksionale për stafin akademik dhe ndihmës, që mbështesin realizimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Zyrat që mbulojnë funksione administrative dhe mbështetëse duke përfshirë Burimet Njerëzore, Financën, Bibliotekën, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretarinë, janë të vendosura në ambiente të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën përkatëse për një funksionim të rregullt dhe efikas.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademikë 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të programit Master i Shkencave në "Financë" rezulton e përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe funksionale për një zhvillim normal të procesit akademik. Departamenti i Financës, si njësi përgjegjëse për programin, operon në mjedise që përfshijnë salla leksionesh, laboratorë të pajisur dhe zyra për stafin akademik dhe</p>

<p>realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>administrativ, duke siguruar mbështetje të plotë për të gjitha komponentët e programit.</p> <p>Hapësirat fizike respektojnë standardet teknike të përcaktuara në VKM nr. 418, datë 10.05.2017, ku kërkohet një minimum prej 2.5 m² për student. Pajisjet didaktike dhe infrastruktura teknike në auditorë i përgjigjen kërkesave të moduleve të programit dhe garantojnë kushte të plota për arritjen e objektivave mësimore dhe profesionale.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni ofron 10 laboratorë të pajisur me programe moderne, të cilat janë të aksesueshme për studentët dhe stafin akademik, për të mbështetur procesin mësimor dhe aktivitetet kërkimore-shkencore. Këto hapësira përdoren për zhvillimin e seminareve, realizimin e detyrave të kursit dhe përgatitjen e temave të diplomës, duke ofruar një mbështetje praktike dhe të strukturuar për studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorëve janë bashkëkohore dhe përfshijnë, përveç aplikacioneve bazë, edhe softuerë të specializuar për lëndët përbërëse të programit. Ndër ta përfshihen Ekonometria, e cila përdor modele statistikore dhe ekonometrike për analizimin dhe interpretimin e të dhënave, si dhe programet SSPS, Eviews, Stata dhe R, që ofrojnë mjetet e nevojshme për analizë të avancuar statistikore dhe ekonometrike.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Institucioni, duke përdorur kapacitetet e veta dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të tjera të formalizuar me marrëveshje të posaçme, siguron që mjediset për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të dedikuara për këtë qëllim.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë i UT vë në dispozicion për studentët ambiente të pajisura, si laboratorë dhe bibliotekë, që mundësojnë zhvillimin e analizave dhe përgatitjen e raporteve në funksion të mbrojtjes së praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.28 Marrëveshje për aksesimin e bibliotekës online - JSTOR.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për zhvillimin e komponentëve praktikë të programit Master i Shkencave në 'Financë', në përputhje me natyrën dhe fushën e tij.</i></p> <p><i>Hapësirat fizike respektojnë standardet teknike të përcaktuara në VKM nr. 418, datë 10.05.2017, ku kërkohet një minimum prej 2.5 m² për student, GVJ evidentoi gjatë vizitës në institucion se rrjedhoje e investimeve të konsiderueshme gjatë viteve të fundit të gjitha ambientet janë ri konstruktuar duke plotësuar standardet e një ambienti të përshtatshëm për mësim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në vëzhgimet e kryera nga GVJ gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës së Universitetit të Tiranës, rezulton se studentëve të programit u ofrohet literaturë bazë dhe ndihmëse sipas modulëve dhe lëndëve, e përcaktuar në syllabus-et përkatëse, si në format fizik, ashtu edhe në version digjital.</p> <p>Fondi i bibliotekës përfshin tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, duke përfshirë publikime të kohëve të fundit që mbështesin formimin akademik dhe zhvillimin e njohurive të studentëve. GVJ vlerëson se biblioteka ofron materiale të specializuara dhe botime të reja në gjuhë të huaj, të cilat mbështesin direkt fushat e programit të Masterit Shkencor në Financë.</p> <p><i>Evidenca 1.28 Marrëveshje për aksesimin e bibliotekës online - JSTOR.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën "Joseph Limprecht", FEUT.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe në konstatimet gjatë vizitës së GVJ pranë bibliotekës, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë i UT dhe Departamenti i Financës, si njësi përgjegjëse, përditësojnë vazhdimisht fondin me botime të kohëve të fundit. Evidencat tregojnë, dhe gjatë vizitës u vërejt se stafi akademik propozon rregullisht shtimin e literaturës bashkëkohore, e cila përdoret në kuadër të programit Master i Shkencave në "Financë". Për më tepër, FEUT siguron çdo vit një fond të veçantë për pasurimin e bibliotekës, duke garantuar përditësimin dhe shtimin e materialeve të nevojshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca 3.3 Dosja përmbledhëse e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p> <p><i>Evidenca 3.4 Plani mësimor i programit të studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p>

	<p><i>Evidenca 3.21 Komunikim nga njësia bazë në çdo fillim viti akademik për përditësim programi të lëndëve</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës së kryer në FEUT, u vërejt se studentët e programit Master i Shkencave në “Financë” kanë akses të plotë në Bibliotekën Mësimore. Ata mund të shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë shërbimet e bibliotekës për studim dhe për përdorimin e literaturës së ofruar. Orari dhe organizimi i shërbimeve janë të përshtatura për nevojat e studentëve, duke qëndruar e hapur nga e hëna deri të premten, nga ora 08:30 deri në 19:30. Gjatë sezonit të provimeve, biblioteka ofron shërbime edhe gjatë fundjavave, në të njëjtin orar, për të siguruar mbështetje maksimale në procesin studimor.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës “Joseph Limprecht” FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën “Joseph Limprecht”, FEUT.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është e pajisur me një fond fizik prej rreth 5,703 titujsh në shqip dhe anglisht, përfshirë tekste mësimore, libra, revista periodike, buletine institucionale, si dhe punime mikroteze dhe doktorature. Shërbimet e bibliotekës sigurohen nga tre punonjës dhe ofrohen në dy ambiente të veçuara: njëri për tërheqjen e librave dhe tjetri si sallë e hapur për studim, duke mundësuar akses të lehtë dhe të organizuar për studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës “Joseph Limprecht” FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën “Joseph Limprecht”, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në</p>	<p>Shërbimet aktuale të bibliotekës ofrojnë akses të barabartë dhe pa kosto për të gjithë përdoruesit, përfshirë studentët dhe stafin akademik, të cilët regjistrohen si anëtarë. Biblioteka ofron gjithashtu shërbime online përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të UT me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për</p>

<p>bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Zhvillim (AADF), duke siguruar abonim në bibliotekën digjitale JSTOR me rreth 85,000 tituj të aksesueshëm.</p> <p>Për më tepër, Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë është pjesë e programit COBIS, që mundëson përdoruesve të saj qasje në baza të dhënash dhe informacion të specializuar në fushën e ekonomisë, të cilat janë të dobishme për analiza dhe punime kërkimore shkencore.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës "Joseph Limprecht" FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën "Joseph Limprecht", FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka përdor një sistem kompjuterik për kërkimin dhe gjetjen e titujve të librave, duke e bërë procesin të shpejtë dhe efikas. Përveç kësaj, kompjuterët në ambientet e bibliotekës janë të aksesueshëm për studentët pa kufizime, duke u mundësuar qasje të plotë në botime online dhe përdorimin e adresave të specializuara që funksionojnë për bibliotekën elektronike.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës "Joseph Limprecht" FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën "Joseph Limprecht", FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron shërbime për studentët e programit nga ora 08:30 deri në 19:30, duke përfshirë edhe studentët që ndjekin mësimin në pasdite. Gjatë sezonit të provimeve, ajo qëndron e hapur edhe të shtunave dhe të dielave në të njëjtin orar, duke garantuar mbështetje të plotë për nevojat e studentëve gjatë gjithë periudhës së provimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës "Joseph Limprecht" FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën "Joseph Limprecht", FEUT.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>

<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ vlerëson se, bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën në Fakultetin e Ekonomisë të UT, ekziston një koordinim i mirëorganizuar për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj.</p> <p>Çdo vit akademik, biblioteka përditësohet sipas nevojave të stafit akademik dhe kërkesave të programeve mësimore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për studentët e programit Master i Shkencave në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Rregullore e brendshme e bibliotekës “Joseph Limprecht” FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Relacion për bibliotekën “Joseph Limprecht”, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Infrastruktura fizike dhe jofizike e kërkimit shkencor, FEUT</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se Fakulteti i Ekonomisë i UT, përmes Departamentit të Financës dhe bibliotekës së tij, siguron kushtet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve praktike për studentët e programit Master i Shkencave në “Financë”, duke garantuar akses në literaturë të përditësuar, mjedise të përshtatshme dhe mbështetje të vazhdueshme për realizimin e moduleve dhe kompetencave praktike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Universiteti i Tiranës përdor platformën “e-student”, e cila mbulon të gjithë ciklin e informacionit, nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të FEUT, ku evidentoi administrimin e të dhënave të studentëve në të gjitha fazat e procesit. U konstatua ekzistenca e regjistrave themeltarë për studentët e programit Master i Shkencave në “Financë”, si dhe u verifikuan raste specifike, duke kontrolluar dosjet fillestare, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vlerësimit dhe regjistrimin e tyre në regjistrin themeltar.</p> <p><i>Evidenca 1.21 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.22 Upgrade i aplikimit software e-studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Fakulteti i Ekonomisë i UT përdor platformën “e-student”, e cila mbulon të gjithë ciklin e informacionit, nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë vizitës, GVJ evidentoi administrimin e të dhënave nga sekretaria mësimore, duke përfshirë regjistrat themeltarë, dosjet e studentëve, regjistrat e grupeve dhe procesverbalet e vlerësimit. Studentët dhe stafi akademik, pas kërkesës, kanë akses në informacionin e menaxhuar nga sekretaria. Për këtë qëllim, Fakulteti ka ngritur dhe funksionon Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SIM), i cili siguron akses të strukturuar dhe të sigurt për përdoruesit e autorizuar, përfshirë pedagogët, studentët dhe stafin IT.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e brendshme e punës Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Sistemi i arkivës FEUT Manual përdorimi.</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Model inventari dhe përditësimi të dosjes së personelit akademik efektiv FEUT.</i></p> <p><i>GVJ nga vizita në FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses të kontrolluar në informacionin e menaxhuar nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SIM). Ky sistem elektronik siguron përdoruesve</p>

<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>të autorizuar, përfshirë pedagogët, studentët, stafin IT, sekretariatë e departamenteve, dekanët dhe zëvendëskanët, qasje të strukturuar dhe të përditësuar mbi të gjitha komponentët e ciklit akademik, përfshirë dosjet e studentëve dhe të stafit akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.25 Përdorues të SIM – ilustrim me foto.</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e brendshme e punës Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Sistemi i arkivës FEUT Manual përdorimi.</i></p> <p><i>Evidenca 2.11 Tabelat përmbledhëse të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, FEUT 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Model inventari dhe përditësimi të dosjes së personelit akademik efektiv FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni, konkretisht Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës (FEUT), siguron shpërndarjen e informacionit përmes platformave dhe moduleve që mundësojnë komunikim interaktiv ndërmjet stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Në veçanti, FEUT përdor Microsoft Teams për ndërveprim të vazhdueshëm gjatë procesit mësimor dhe administrativ. Informacioni plotësues dhe njoftimet zyrtare shpërndahen gjithashtu përmes faqes zyrtare të fakultetit, rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera institucionale, duke garantuar transparencë dhe akses të gjerë në të dhëna.</p> <p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 2.34 Platforma e-learning Microsoft teams dhe trajnimi i stafit FEUT për përdorim FEUT</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Universiteti i Tiranës siguron informacionin e nevojshëm përmes platformës e-student, e cila është e integruar me SIM dhe mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të strukturuar të informacionit ndërmjet personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve. Sistemi lejon gjenerimin e raporteve individuale për studentët dhe stafin akademik, duke mbështetur monitorimin e regjistrimeve, notave, progresit akademik dhe ngarkesës mësimore. Komunikimi zyrtar dhe vijueshmëria e ndërveprimit sigurohen gjithashtu përmes Microsoft Teams dhe e-mailit institucional.</p>

	<p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 2.34 Platforma e-learning Microsoft teams dhe trajnimi i stafit FEUT për përdorim</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga konstatimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), faqja zyrtare e Fakultetit të Ekonomisë të UT përmban informacion të detajuar mbi programet e studimit, stafin akademik, oraret, datat e provimeve dhe mundësitë e punësimit për studentët. Përveç publikimeve në gjuhën shqipe, një pjesë e konsiderueshme e njoftimeve dhe informacionit publikohet edhe në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht.</p> <p>FEUT është gjithashtu aktiv në rrjetet sociale, duke shpërndarë vazhdimisht informacione mbi programet, aktivitetet akademike dhe ndërkombëtare, duke rritur vizibilitetin dhe aksesin për një audiencë më të gjerë.</p> <p>https://feut.edu.al/</p> <p>https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-finances/njoftime-te-departamentit-e-finances</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se FEUT, përmes Departamentit të Financës dhe bibliotekës, siguron menaxhim të strukturuar të të dhënave, akses të kontrolluar për stafin akademik dhe studentët, si dhe informacion të përditësuar dhe të qasshëm mbi programin dhe aktivitetet e studimit, duke garantuar transparencë, ndërveprim efektiv dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët e Masterit të Shkencave në "Financë".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konstaton se FEUT ka hartuar për këtë program studimi një plan financiar të detajuar, duke llogaritur kostot për studentët në bazë të elementëve përbërës të shpenzimeve dhe të ardhurave të pritshme. Kjo pasqyrohet qartë edhe në projekt-buxhetet dhe buxhetet e miratuara çdo vit, të cilat sigurojnë funksionimin e qëndrueshëm të programit gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.36 Plani financiar i programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar i Departamentit të Financës, si njësia përgjegjëse për programin e studimit në FEUT, përfshin llogaritjen e kostos për student, parashikimin e të ardhurave nga tarifat dhe burime të tjera financiare, si dhe hartimin e buxheteve vjetore të miratuara, të cilat sigurojnë financimin e aktiviteteve akademike gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ky plan garanton administrimin dhe monitorimin e shpenzimeve në përputhje me objektivat e programit, duke siguruar mbarëvajtjen dhe qëndrueshmërinë e Masterit të Shkencave në "Financë".</p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.36 Plani financiar i programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se procesi i auditimit dhe planifikimit buxhetor në FEUT është i organizuar në përputhje me procedurat institucionale. Auditimet vjetore, të kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, e cila raporton drejtpërdrejt të Bordi i Administrimit, fokusohen në menaxhimin e fondeve dhe evidentimin e ecurive dhe çështjeve financiare. Planifikimi buxhetor afatmesëm, i miratuar nga Senati Akademik, dhe projekt-buxhetet vjetore bazohen në propozimet e njësive kryesore, konkretisht të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Financës, duke zbatuar parimin e hallkës bazë në planifikim.</p> <p><i>Evidenca 1.31 Program dhe raport auditimi UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.36 Plani financiar i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Ekonomisë sigurojnë që njësia bazë përgjegjëse për këtë program merr raportime të detajuara mbi ekzekutimin e buxhetit të vitit të kaluar. Ky proces përfshin shqyrtimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, duke garantuar transparencë dhe mbikëqyrje efektive të përdorimit të fondeve, në përputhje me objektivat e Masterit Shkencor në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.36 Plani financiar i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të</p>	<p>Universiteti i Tiranës, si institucion, dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, tregojnë një qëndrueshmëri financiare të fortë, duke siguruar mbulimin e shpenzimeve përmes të ardhurave të gjeneruara. Kjo mbështetet kryesisht nga numri i studentëve dhe të ardhurat nga projektet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione homologe, vendase dhe ndërkombëtare. Ky model financimi dhe menaxhimi i</p>

<p>këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>qëndrueshëm i burimeve garanton mbarevajtjen e Masterit Shkencor në “Financë” dhe siguron zhvillimin e pandërprerë të aktiviteteve akademike.</p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i> <i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i> <i>Evidenca 1.31 Program dhe raport auditimi UT</i> <i>Evidenca 2.36 Plani financiar i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se FEUT dhe Departamenti i Financës kanë vendosur një sistem të qëndrueshëm dhe të organizuar për menaxhimin e burimeve financiare të programit. Plani financiar mbulon shpenzimet për studentët dhe aktivitetet akademike, duke përdorur të ardhura nga tarifat dhe projektet e bashkëpunimit.</i></p> <p><i>Auditimet vjetore dhe raportimet e detajuara deri në njësitë bazë sigurojnë transparencë dhe kontroll të ecurisë financiare. Ky model garanton mbarëvajtjen dhe zhvillimin e pandërprerë të Masterit Shkencor në “Financë”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
-----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	-------------------------------------------------------------------

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

76

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni ka vendosur dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga regjistrimi deri të diplomimi, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. Në këtë kuadër përfshihen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statuti i Universitetit; 2. Rregullorja e Universitetit; 3. Rregullorja e programit të studimit të FEUT. <p>Këto dokumente përcaktojnë me hollësi të gjitha hapat dhe procedurat për ndjekjen e progresit të studentëve, nga fillimi i programit deri në përfundimin e tij, duke siguruar një proces akademik të drejtë, transparent dhe të strukturuar.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vëren se përmes politikave dhe procedurave të vendosura, cikli akademik i studentëve sigurohet të zhvillohet në kushte barazie dhe respektim të të drejtave të tyre. Studentët udhëhiqen gjatë gjithë programit përmes procedurave të dokumentuara në rregulloren e FEUT. Njësitë përkatëse kryejnë miratimin e këtyre procedurave, ndërsa informacioni është i disponueshëm për publikun në faqen zyrtare të fakultetit. Këto mekanizma mbështesin çdo hap të përparimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve të Masterit Shkencor në "Financë".</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të përmendur më sipër, GVJ konstaton se kriteret e pranimi për kandidatët e Masterit Shkencor në "Financë" janë të qarta dhe të dokumentuara në mënyrë transparente. FEUT përcakton kriteret dhe kuotat në përputhje me kapacitetet e programit, duke garantuar një proces pranimi të drejtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar.</p>

<p>strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.3 Propozim dhe vendim për kuotat e plota sipas prograve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen, përparimin, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve janë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme në rregulloret e Universitetit të Tiranës, të FEUT dhe të programit të Masterit Shkencor në "Financë". Në aktet rregullatore të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi janë specifikuar qartë kriteret për pranimin dhe transferimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Kriteret e pranimit të studimeve në ciklin e parë dhe të dytë në FEUT, 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës përgjegjës për programin e Masterit Shkencor në "Financë" organizon çdo fillim viti seanca informimi me studentët, ku prezantohen detajet e programit, organizimi i departamentit dhe kriteret e aplikimit. Ky informacion, përfshirë kriteret e përgjithshme dhe specifike, bëhet i disponueshëm gjithashtu në faqen zyrtare të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Kriteret e pranimit të studimeve në ciklin e parë dhe të dytë në FEUT, 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta</p>	<p>Çdo vit të ri akademik, UT përcakton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, si dhe për anëtarët e grupeve të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>

<p>për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë sipas rregullores së programit të Masterit Shkencor në “Financë”, ndërsa kriteret specifike të pranimit për secilin program hartohen në bashkëpunim me njësinë bazë dhe njësinë kryesore, duke u përshtatur me kërkesat dhe karakteristikat e veçanta të programit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.3 Propozim dhe vendim për kuotat e plota sipas prograve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Brenda kuadrit rregullativ të Universitetit të Tiranës, të përmendur më sipër, nenet dhe kriteret e pranimit përcaktojnë gjithashtu kërkesat specifike për kandidatët që vijnë nga shtete të huaja.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Kriteret e pranimit të studimeve në ciklin e parë dhe të dytë në FEUT, 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbatohet politika për ndihmën dhe bursat studentore, me qëllim mbështetjen e studentëve në nevojë dhe rritjen e cilësisë së pranimit në programet prioritare për institucionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas këtyre politikave, UT ofron bursa të plota ose të pjesshme dhe tarifa të reduktuara për studentët me performancë të lartë akademike, si dhe për ata me vështirësi sociale dhe ekonomike. Informacioni mbi mundësitë e bursave publikohet në faqen zyrtare të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.16 Buxheti Vjetor për vitet 2023,2024 dhe 2025 FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.17 Informacion për grantin Planin buxhetor njëvjeçar dhe afatmesëm, FEUT, 2022-2024.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se UT ka politika të qarta dhe të strukturuar për ndihmën dhe bursat studentore, të cilat synojnë mbështetjen e studentëve me nevoja ekonomike dhe përmirësimin e performancës akademike të lartë.</i></p>

	<i>Shpërndarja e bursave dhe ulja e tarifave zbatohet në mënyrë transparente, duke siguruar akses të barabartë dhe mbështetje efektive për studentët e Masterit Shkencor në "Financë".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë procesit të vlerësimit dhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ evidenton se studentët e programit marrin informacion të rregullt dhe të strukturuar për progresin e tyre akademik.</p> <p>Të dhënat e përgjithshme mbi oraret, provimet, njoftimet institucionale dhe aktivitetet informuese publikohen në faqet zyrtare të UT dhe FEUT. Ndërkohë, për secilën lëndë, të dhënat specifike lidhur me përmbajtjen, format e vlerësimit dhe literaturën komunikohen që në javën e parë të zhvillimit të modulit përmes sesioneve udhëzuese nga pedagogët përkatës. Studentët kanë gjithashtu mundësi të drejtpërdrejtë komunikimi përmes e-mail-eve institucionale dhe kontakteve të grupit mësimor, ndërsa informacione shtesë gjenden në faqet individuale të stafit akademik, në sekretarinë mësimore dhe në materialet orientuese të programit të ofruara nga Departamenti i Financës. Kjo shumëllojshmëri kanalesh komunikimi siguron akses të vazhdueshëm dhe të plotë në informacionin akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.21 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ vlerëson se Departamenti i Financës, në bashkëpunim me njësitë e tjera të UT, siguron informim të plotë dhe të vazhdueshëm për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo të studimeve të pjesshme. Informacioni ofrohet përmes ditëve të dedikuara informuese, komunikimeve të rregullta dhe dokumenteve rregullatore institucionale, duke u bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe në praktikat për transferimet dhe njohjet akademike. Këto masa garantojnë transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë studentët që synojnë ndjekjen e programit Master Shkencor në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.35 Praktika e njohjes dhe transferimit të krediteve (ECTS) të studimeve.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë” përmban qartësisht të gjitha procedurat që lidhen me vlerësimin e dijes dhe format e provimeve. Janë të përcaktuara llojet e vlerësimeve për çdo modul, përfshirë provimet e pjesshme, ato përfundimtare, si dhe mënyra e organizimit dhe realizimit të tyre. Në fillim të çdo semestri, gjatë seminarit udhëzues në javën e parë, pedagogët prezantojnë syllabus-in dhe udhëzojnë studentët mbi afatet dhe format e përbushjes së detyrimeve akademike. Informimi i vazhdueshëm mbështetet nga platformat elektronike të institucionit, rrjeti zyrtar i email-ave të UT dhe FEUT, si dhe nga komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët për çdo çështje të lidhur me vlerësimin.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Guida studentore UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p> <p><i>Evidenca 3.5 Programet e lëndëve mësimore të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”, në shqip dhe në anglisht për vitet akademike 2021-2025.</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me studentët</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës, si njësi bazë përgjegjëse për programin Master i Shkencave në “Financë”, informon studentët dhe pedagogët udhëheqës mbi temat e mikrotezave përmes adresave elektronike zyrtare. GVJ konstaton se studentët janë të njohur me kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, të cilat u komunikohen si nëpërmjet udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë nga pedagogët udhëheqës. Këta të fundit ndjekin gjithashtu procesin e praktikës profesionale. Informacioni përkatës publikohet edhe në faqen zyrtare të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.6 Format i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës për programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p> <p><i>Evidenca 3.14 Format mikroteze dhe formular vlerësimi mikroteze për programin e studimit “Master i Shkencave”.</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Studentët, që nga faza e aplikimit dhe gjatë gjithë zhvillimit të studimeve, marrin informacion të plotë dhe të strukturuar mbi proceset akademike dhe mundësitë e karrierës. Ky informacion u ofrohet përmes kontakteve direkte me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, sekretarinë mësimore, udhëzuesit e studentëve, faqen e institucionit dhe burime të tjera të përcaktuara, si dhe gjatë aktiviteteve si “open days” të organizuara nga FEUT. Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejti se ata janë të informuar dhe marrin materialet në mënyrë të qartë dhe të përditësuar gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe më pas.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Guida studentore UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.27 Udhëzues për funksionimin e Zyrës së karrierës, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT</i></p>

	<p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p> <p><i>Evidenca 3.22 Broshura e Departamentit të Financës, FEUT "Edukim, Kërkim, Profesionalizëm".</i></p> <p><i>Takim me studentët gjatë vizitës në institucion.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se UT dhe FE ofrojnë dokumentacion të detajuar që mbulon të gjitha aspektet e informimit të studentëve, përfshirë kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit, detyrimet akademike dhe vlerësimin gjatë programit, mbrojtjen e punimeve të diplomës, si dhe rregullat për pranimin dhe transferimin e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>UT dhe FE përdorin forma të ndryshme për të informuar studentët mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Përveç takimeve informuese gjatë fazës së aplikimit përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës (ZKK) dhe sekretarisë mësimore, studentët njoftohen mbi detajet e programit edhe përmes shpalljeve zyrtare, strukturës së programit dhe syllabusve. Gjithashtu, gjatë prezantimit të parë në javën e parë të semestrit, pedagogët ofrojnë orientim të detajuar mbi programin dhe pritshmëritë akademike.</p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"</i></p> <p><i>Evidenca 3.4 Plani mësimor i programit të studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.5 Programet e lëndëve mësimore të programit të studimit "Master i Shkencave në Financë", në shqip dhe në anglisht për vitet akademike 2021-2025</i></p>

	<i>Takim me studentët gjatë vizitës në institucion.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Para regjistrimit, studentët marrin informacion përmes Guidës së Studentit, komunikimeve të drejtpërdrejta dhe faqes zyrtare të FEUT, që u shërben për orientim mbi programin. Pas regjistrimit, ata sigurohen të marrin informacion të hollësishëm dhe të vazhdueshëm mbi përmbajtjen e lëndëve, detyrimet e frekuentimit, procedurat e vlerësimit gjatë vitit akademik dhe në përfundim. Departamenti i Financës si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, garanton qasje të plotë në të gjitha të dhënat mbi strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të Master Shkencor në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 1.32 Guida studentore UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.4 Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”, për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.5 Programet e lëndëve mësimore të programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”, në shqip dhe në anglisht për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.22 Broshura e Departamentit të Financës, FEUT “Edukim, Kërkim, Profesionalizëm”</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Sipas raportit të RVB-së dhe vëzhgimeve gjatë vizitës në institucion, u vërtetua se studentët marrin informacion mbi mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës (ZKK). Ky informacion përditësohet rregullisht dhe është i aksesueshëm përmes të gjitha kanaleve të komunikimit të përmendura më parë. Studentët janë të njohur mirë me mundësitë e punësimit që nga fillimi i programit dhe gjatë gjithë ciklit akademik, përfshirë edhe bashkëpunimet që institucioni ka me aktorë të ndryshëm të biznesit në vend.</p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”</i></p> <p><i>Evidenca 3.2 Plani strategjik i programit të studimit “Master i Shkencave në Financë”, për vitet 2020-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 Analiza e tregut të punës dhe alumnit për studentët e Departamentit të Financës, FEUT 2022</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët mund të marrin informacion të plotë mbi kriteret e përmendura më lart, si përmes kanaleve elektronike, ashtu edhe përmes kontakteve direkte me stafin akademik të programit, drejtuesit e njëjësive përkatëse, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Vendimi i për emërimin e koordinatorit të programit të studimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë"</i></p> <p><i>Evidenca 3.22 Broshura e Departamentit të Financës, FEUT "Edukim, Kërkim, Profesionalizëm"</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik, studentët dhe Zyrën e Karrierës të FEUT gjatë vizitës në institucion.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i informacionit, në të gjitha format e tij të përmendura më parë, është i disponueshëm edhe për studentët që ndjekin programin në distancë. Gjatë takimit me studentët, ata vlerësuan pozitivisht lehtësinë dhe qartësinë e aksesit në informacion.</p> <p><i>Evidenca 1.21 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.22 Upgrade i aplikimit software e-studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se FEUT ofron mënyra të ndryshme për të informuar studentët mbi strukturën dhe funksionimin e programit të studimeve.</i></p> <p><i>Studentët kanë qasje të plotë në informacion përmes kanaleve elektronike dhe përfitojnë nga një platformë e dedikuar për menaxhimin dhe shpërndarjen e të dhënave të brendshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar dhe gjatë vizitës në institucion, në takimin me sekretarinë mësimore u vëzhgua administrimi i statistikave vjetore për studentët që kanë përfunduar këtë program studimi. FEUT ruan dhe përditëson çdo vit të dhënat dhe statistikat, duke përfshirë numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik.</p> <p>Sipas tabelave përmbledhëse të RVB, numri total i studentëve të diplomuar gjatë periudhës 2022–2025 është: 297.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Evidenca 2.5 Relacion për studentët e regjistruar dhe të diplomuar sipas viteve akademike për MSHF, 2019-2020 deri në 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025</i></p>										
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas RVB-së, dokumentacionit të dorëzuar dhe gjatë vizitës në institucion, u vëzhgua administrimi i statistikave vjetore për studentët e regjistruar në këtë program, duke përfshirë edhe rastet e largimeve para përfundimit të studimeve. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit në sekretarinë mësimore, ku u verifikua regjistri themeltar i studentëve të programit. Universiteti disponon statistika të hollësishme për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, të cilat sekretaria mësimore i ruan dhe i përditëson rregullisht sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Të dhënat mbi regjistrimet për vitet akademike 2022–2025 janë:</p> <table border="1" data-bbox="603 1630 1356 1854"> <thead> <tr> <th>Programi i Studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Të regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Master i Shkencave në "Financë"</td> <td>2022-2023</td> <td>119</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>120</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>121</td> </tr> </tbody> </table>	Programi i Studimit	Viti Akademik	Të regjistruar	Master i Shkencave në "Financë"	2022-2023	119	2023-2024	120	2024-2025	121
Programi i Studimit	Viti Akademik	Të regjistruar									
Master i Shkencave në "Financë"	2022-2023	119									
	2023-2024	120									
	2024-2025	121									

	<p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FEUT menaxhon në mënyrë të organizuar ecurinë akademike të studentëve të programit përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Ky sistem përfshin regjistra të printuar dhe dokumente elektronike, si procesverbalet e provimeve dhe riprovimeve, si dhe regjistrin themeltar.</p> <p>Platforma e-student siguron ruajtjen e konfidencialitetit dhe ofron akses të shpejtë në informacion, si për studentët, ashtu edhe për auditimin dhe verifikimin nga organet përkatëse. Evidencat janë të përputhshme me dokumentacionin zyrtar, duke krijuar një bazë të plotë dhe të besueshme të të dhënave akademike.</p> <p><i>Evidenca 1.21 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.22 Upgrade i aplikimit software e-studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 1.23 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 1.24 Sistemi e-studenti Manual përdorimi për pedagogët.</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Rregullore e degës së sekretarisë mësimore FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Sistemi i arkivës FEUT Manual përdorimi.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Dokumentacioni i dorëzuar dhe verifikimet gjatë vizitës në institucion tregojnë se FEUT ndjek praktika të rregullta për kontrollin dhe përditësimin e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore ruan evidenca të organizuara, që përfshijnë procesverbalet e provimeve, regjistrin themeltar dhe dokumentacionin mbështetës, të cilat administrohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Institucioni siguron që të dhënat të jenë të sakta, të përputhshme dhe konfidenciale, në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.21 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT.</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.22 Upgrade i aplikimit software e-studenti.</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 Rregullore e degës së sekretarisë mësimore FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Sistemi i arkivës FEUT Manual përdorimi.</i></p> <p><i>Evidenca 3.20 Format regjistri semestral për seminarin në procesim mësimor.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>FEUT përgatit rregullisht raporte vjetore mbi analizën mësimore-shkencore të programit të studimit. Këto raporte pasqyrojnë ecurinë e procesit mësimor, cilësinë e pranimeve dhe diplomimeve të studentëve, si dhe evidentojnë problematikat dhe prioritetet për përmirësim të mëtejshëm. GVJ vëren se raportet përbëjnë një mjet të rëndësishëm për vlerësimin dhe planifikimin e zhvillimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 Analiza e tregut të punës dhe alumnit për studentët e Departamentit të Financës, FEUT 2022-1-44.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni i përmbush kriteret për hartimin dhe zbatimin e politikave që sigurojnë informimin, ndjekjen dhe dokumentimin e plotë të ciklit akademik të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim.</i></p> <p><i>Procedurat janë të qarta dhe të formalizuara në aktet rregullative të UT dhe FE, ndërsa informacioni menaxhohet në mënyrë të sigurt dhe të kontrollueshme përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe dokumentacionit zyrtar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe</p>	<p>Përmes kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi, Universiteti i Tiranës siguron përfshirjen e studentëve në strukturat kryesore</p>

<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Kjo përfaqësim përfshin Senatën Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Kurrikulës, NJSBC-në, si dhe strukturat homologe në Fakultetin e Ekonomisë, përfshirë grupet e vetëvlerësimit dhe NJSBC-në në nivel fakulteti. Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 dhe akteve të brendshme, funksionon gjithashtu Këshilli i Studentëve, që ka për detyrë të përfaqësojë interesat e tyre në mënyrë institucionale. Evidencat tregojnë pjesëmarrje të rregullt dhe aktive të studentëve në mbledhjet dhe vendimmarrjet e këtyre organeve.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i> <i>Evidenca 1.6 Kodi i etikës së UT.</i> <i>Evidenca 1.12 Rregullore për zgjedhjet të Këshillave të Studentëve në UT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të aplikimit pranë ASCAL-it dhe konstatimeve të bëra gjatë takimit me studentët në kuadër të vizitës së GVJ, rezultojnë se studentët dhe përfaqësuesit e tyre janë të angazhuar aktivisht në strukturat vendimmarrëse të institucionit. Ata marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, përmes anketimeve të rregullta dhe diskutimeve të hapura me pedagogët e lëndëve përkatëse. Gjithashtu, pjesëmarrja e një studenti në përbërje të Grupit të Vetëvlerësimit të programit siguron përfshirjen e zërit të studentëve në procesin e analizës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizmin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 2.1 Vendimi i grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të</p>	<p>Studentët kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit përmes pjesëmarrjes në vlerësime të organizuara nga NJSBC, ku jepet feedback mbi përmbajtjen mësimore dhe procesin e mësimdhënies. Përveç kësaj, interaksioni i</p>

<p>studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>drejtpërdrejtë me pedagogët shërben si kanal shtesë për adresimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se nuk janë bërë ndryshime zyrtare në kurrikulë nga viti 2022, por lektorët kanë pasuruar temat e trajtuara duke përfshirë elemente bashkëkohore që reflektojnë zhvillimet aktuale në fushën e financave dhe teknologjisë.</p> <p><i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizmin dhe funksionimin e njërive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në përputhje me kuadrin rregullativ të institucionit dhe bazuar në takimin e zhvilluar midis GVJ dhe studentëve të programit, u konstatua se studentët kanë hapësira të përcaktuara për të kontribuar në përmirësimin e programit dhe në procesin e mësimdhënies. Ky përfshirje realizohet nëpërmjet anketave të organizuara nga NJSBC, si dhe përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me pedagogët.</p> <p>Nga diskutimet me studentët nuk u identifikuan shqetësime lidhur me mënyrën e vlerësimit, ndërsa u theksua një qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj procesit mësimor. Institucioni, nga ana tjetër, ka në fuqi rregullore dhe udhëzime që garantojnë të drejtën e ankimit dhe angazhimin e studentëve në proceset e vlerësimit dhe zhvillimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Rregullore për organizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Financë".</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademikë 2021-2025</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se studentët e programit Master i Shkencave në "Financë" kanë akses të plotë në informacion mbi strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të programit, përmes platformave elektronike, stafit akademik dhe Zyrës së Karrierës.</i></p>

	<i>Ata janë të përfshirë në organet përfaqësuese dhe vendimmarrëse të institucionit dhe kanë mundësi të kontribuojnë me opinionet e tyre për përmirësimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Në bazë të strukturës administrative të Universitetit të Tiranës, janë krijuar mekanizma të qartë për informimin dhe mbështetjen e studentëve, të cilët mbështeten në aktet rregullative të miratuara nga organet vendimmarrëse. Në nivel rektorati, Drejtoria e Komunikimit operon përmes tre sektorëve, ku Sektori i Marrëdhënieve me Studentët monitoron dhe menaxhon informacionin që u ofrohet studentëve në forma të ndryshme.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Departamentit të Financës, studentët kanë qasje në informacion përmes Zyrës së Shërbimeve, Zyrës së Karrierës dhe Zyrës së Informacionit. Informacioni i detajuar dhe i përditësuar mund të gjendet gjithashtu në guidën e studentit dhe në faqen zyrtare të fakultetit. Përveç kësaj, komunikimi elektronik, platformat e mësimi online si Microsoft Teams, si dhe aktiviteti në rrjetet sociale ofrojnë kanale shtesë për qasje të vazhdueshme në informacion.</p> <p><i>Evidenca 1.32 Guida studentore UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe	Strukturat e informimit të studentëve, veçanërisht në nivel fakulteti dhe departamenti, kanë krijuar një sistem të plotë dhe dinamik komunikimi, i cili mbulon të gjithë ciklin e studimeve, nga regjistrimi deri të diplomimi. Informimi ofrohet kryesisht përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Informacionit dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës, si dhe përmes kontakteve direkte me

<p>asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>stafin akademik dhe njësitë bazë të institucionit. Sistemi përforcohet nga përdorimi i platformave elektronike, rrjeteve sociale dhe ekraneve të vendosura në ambientet e përbashkëta të fakultetit, duke siguruar shpërndarje të shpejtë, të qartë dhe të vazhdueshme të informacionit për studentët.</p> <p><i>Evidenca 1.32 Guida studentore UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.22 Broshura e Departamentit të Financës, FEUT "Edukim, Kërkim, Profesionalizëm"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Një element kyç i sistemit të informimit për studentët është Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila, përveç mbështetjes së kandidatëve gjatë regjistrimit në program, ofron informacion mbi mundësitë e punësimit, trajnimeve dhe praktikave profesionale.</p> <p>Zyra ndjek gjithë procesin e informimit për studentët, duke bashkëpunuar me struktura të tjera të institucionit për të siguruar informacion të plotë dhe të saktë. Për më tepër, Zyra mban lidhje të ngushta me tregun e punës, duke orientuar studentët drejt mundësive praktike dhe punësimit pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.27 Udhëzues për funksionimin e Zyrës së karrierës, FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron në mënyrë të vazhdueshme punësimin e studentëve gjatë studimeve dhe pas diplomimit. Çdo vit akademik, ajo përgatit një raport analitik, të përditësuar për secilin nivel programi, i cili përfshin të dhëna mbi punësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve dhe strukturave drejtuese për të mbështetur vendimmarrjen dhe orientimin profesional.</p> <p><i>Evidenca 2.28 Aktivitete, raporte dhe formularë vlerësimi nga Zyra e Karrierës FEUT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.11 Analiza e tregut të punës dhe alumnit për studentët e Departamentit të Financës, FEUT 2022-1-44.</i></p>

Konkluzione	<p><i>FEUT ka struktura të dedikuara për monitorimin e progresit dhe ecurisë së programit Master Shkencor në "Financë". Sekretaria Mësimore dhe ZKK përbëjnë kanalet kryesore të informimit për studentët, duke mbuluar periudhën para regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe pas diplomimit.</i></p> <p><i>Këto zyra mbikëqyrin progresin akademik dhe ofrojnë mbështetje për zhvillimin profesional, duke siguruar informacion të përditësuar, të verifikueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm për të gjithë studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të aplikimit, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe takimet me stafin akademik e studentët, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se Universiteti i Tiranës ka ngritur një sistem funksional dhe të qartë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me strategjinë institucionale dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Institucioni ka krijuar një kuadër rregullativ të plotë që mbështet operimin e këtij sistemi, duke përfshirë politikat dhe procedurat që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në nivel institucional funksionon Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila vepron sipas rregullores së miratuar nga</p>

	<p>UT. Strategjia e Zhvillimit 2023–2028 përfshin masa konkrete për përdorimin e metodave inovative në procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Strategjia e zhvillimit të UT, 2023-2028.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.15 Metoda inovative të mësimdhënies model lënde në programin e studimit “Master i Shkencave në Financë”.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Duke u mbështetur në Statutin e UT, organigramën institucionale, dokumentacionin e Fakultetit të Ekonomisë (FE), Manualin e Cilësisë dhe takimet e zhvilluara, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm GVJ vlerëson se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit realizohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës.</p> <p>Ky proces mbështetet nga Rregullorja “Për sigurimin e cilësisë në UT” dhe instrumentet përkatëse të cilësisë, duke përfshirë edhe funksionimin e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në nivel fakulteti, FE ka ngritur Degën e Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC-në përkatëse, të cilat operojnë sipas rregullores institucionale. Këto struktura monitorojnë dhe vlerësojnë mësimdhënien përmes analizës së performancës akademike të stafit të Departamentit të Financës si dhe përmes anketimeve me studentët në fund të çdo semestri.</p> <p>Rezultatet përpunohen në raporte dhe i dërgohen instancave vendimmarrëse. Një tjetër mekanizëm vlerësimi është hartimi, në fillim të vitit, i planit individual të ngarkesës mësimor-shkencore për çdo pedagog, i cili monitorohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Financës. Përmeshja e këtij plani shërben si tregues i performancës akademike. <i>Shqyrtimi i të dhënave tregon se disa pedagogë mbulojnë deri në kufirin maksimal të lejuar 5–6 lëndë në disa programe studimi, me një ngarkesë mësimore prej 400–480 orësh në vit, e cila nga ana e GVJ konsiderohet relativisht e lartë.</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademikë 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Vlerësimi i rregullt i mësimdhënies dhe aktivitetit akademik-administrativ në Universitetin e Tiranës dhe Fakultetin e Ekonomisë realizohet përmes strukturave përgjegjëse dhe instrumenteve të dedikuara për cilësinë. Në këtë proces përfshihet edhe opinioni i studentëve, të cilët çdo semestër plotësojnë anketa mbi cilësinë e lëndëve, performancën e pedagogëve dhe përvojën në praktikat profesionale.</p> <p>Të dhënat e mbledhura analizohen dhe përpunohen në raporte që i komunikohen stafit dhe diskutohen në nivel departamenti, me synim përmirësimin e procesit mësimor dhe vlerësimin përfundimtar të pedagogëve në fund të vitit akademik. Për më tepër, përdoren formularë standard për të vlerësuar performancën e stafit, sidomos për ata me kontrata të përkohshme, ku vlerësohet jo vetëm mësimdhënja, por edhe veprimtaria kërkimore dhe angazhimi institucional.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca mbi rezultatet e përfituara nga paketa e cilësisë NJSBC. (evidence shtese e ardhur pas vizitës ne institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies në Fakultetin e Ekonomisë realizohet nga strukturat përgjegjëse, përkatësisht Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe departamenti e Financës. Këto njësi hartojnë raporte periodike vlerësimi, të cilat shpërndahehen tek strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit, por edhe tek vetë pedagogët dhe aktorët e tjerë të interesuar. Sipas rregullores përkatëse, NJSBC fillimisht komunikon rezultatet e vlerësimit me stafin akademik dhe më pas i adreson ato tek strukturat vendimmarrëse të fakultetit. Këto raporte diskutohen në nivel departamenti dhe përdoren si bazë për ndërhyrje konkrete dhe përmirësime të vazhdueshme në procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NjSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe nga takimet në terren me stafin akademik, GVJ vlerëson se institucioni zbaton mekanizma të strukturuar për vlerësimin e mësimdhënies, të cilët ndihmojnë në identifikimin dhe promovimin e praktikave të mira. Vlerësimi i personelit zhvillohet si në nivel të njësive kryesore, ashtu edhe në nivel njësisish bazë, dhe shoqërohet me diskutime konstruktive në mbledhjet e departamenteve.</p> <p>Pjesëmarrja e stafit në projekte ndërkombëtare si ERASMUS+ përforcon këtë qasje dhe shërben si nxitje për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie. Eksperienca profesionale dhe kualifikimi i stafit akademik janë faktorë thelbësorë për arritjen e objektivave mësimore dhe konsolidimin e standardeve të larta brenda institucionit.</p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), FEUT, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca shtesë: Lista e mobiliteteve për stafin dhe studentët</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni ka vendosur mekanizma funksionalë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilët përfshijnë analizën e raporteve, diskutimet në nivel departamenti dhe promovimin e praktikave të mira që mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm.</p> <p>Një drejtim i rëndësishëm i përfshirjes së studenteve të këtij programi në dhënien e mendimeve të tyre është edhe realizimi i pyetësorëve me ta lidhur me vlerësimin e zhvillimit të lendes dhe të pedagogut përkatës që zhvillon atë.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, UT ka përcaktuar politika të qarta dhe ka ngritur struktura funksionale për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel njësie kryesore, përfshirë Fakultetin e Ekonomisë, që mbulon programin Master i Shkencave në “Financë”.</p> <p>GVJ vlerëson se janë miratuar akte nënligjore që rregullojnë funksionimin e brendshëm të institucionit, me fokus në cilësinë e programeve të studimit. Ky sistem mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe rregulloren përkatëse, të miratuara nga Senati Akademik. Zbatimi i këtij kuadri rregullativ mbështetet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe nga Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), të ngritura dhe funksionale në të gjitha nivelet, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i> <i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i> <i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), FEUT, 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për</p>	<p>Në nivel institucional, përgjegjësia për sigurimin e cilësisë i takon Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve dhe të Cilësisë (KPSSC), si dhe Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Në nivel fakulteti, pranë FEUT funksionon Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ndjek, monitoron dhe kontribuon në përmirësimin e</p>

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>vazhdueshëm të cilësisë në proceset mësimore dhe kërkimore. Kjo njësi përbëhet nga tetë anëtarë, përfshirë edhe një përfaqësues studentor, çka siguron një përfaqësim të balancuar në procesin e vlerësimit.</p> <p>NJSBC bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë të fakultetit, në veçanti me koordinatoret e programeve dhe me departamentet akademike. Sipas rregullores përkatëse, njësi aplikon një sërë metodash vlerësimi, duke përfshirë anketimet me studentët, takimet direkte me ta dhe konsultimet me koordinatoret e programeve. Pas përfundimit të procesit të grumbullimit të informacionit, NJSBC harton një raport periodik ku identifikohen problematikat dhe gjetjet kryesore. Ky raport u paraqitet strukturave përgjegjëse në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti, për analizë dhe ndërhyrje të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Tabelat përmbledhëse të RVB për programin e studimit "Master i Shkencave në Financë", për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 Plani i veprimtarisë së i NJSBC-së UT 2024-2028</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se sigurimi i jashtëm i cilësisë në Universitetin e Tiranës realizohet përmes procesit të vlerësimit dhe akreditimit institucional, në bashkëpunim me ASCAL-in. UT është akredituar me Vendimin nr. 04, datë 27.01.2023 të Bordit të Akreditimit, duke përmbushur standardet institucionale të kërkuara. Akreditimi mbetet në fuqi deri më 27.01.2029.</p> <p>Në mënyrë paralele, institucioni ka nisur edhe procesin e akreditimit të disa programeve të studimit. Për përgatitjen e këtyre proceseve, ngrihen GVB-të, të cilat veprojnë në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë të UT.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.16 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit e Standardeve të Cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloret dhe manualët përkatëse të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Ekonomisë janë të përcaktuara qartë politikat institucionale për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Procesi i vlerësimit të cilësisë bazohet në pyetësorët e plotësuar nga studentët dhe në vlerësimin e performancës së stafit akademik nga NJSBC, në përputhje me kriteret e përcaktuara. Rezultatet përpunohen dhe përfshihen në raportin vjetor të cilësisë, i cili i dorëzohet strukturave përgjegjëse për analizë dhe vendimmarrje.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca shpeshë: Mbi rezultatet e përfituara nga "Paketa e Instrumentave të Cilësisë"</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se UT ka politika të mirëpërcaktuara dhe struktura funksionale për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Procesi mbështetet në vlerësimin e studentëve përmes pyetësorëve dhe në monitorimin e performancës së stafit nga NJSBC.</p> <p><i>Të dhënat përpunohen, përfshihen në raportin vjetor të cilësisë dhe i raportohen strukturave përkatëse, duke siguruar funksionimin e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar të vlerësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se, sipas RVB-së dhe dokumentacionit të aplikimit pranë ASCAL-it, Fakulteti i Ekonomisë përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e cilësisë. Këto përfshijnë kontrollet nga drejtuesit e njësisë kryesore, analizat dhe diskutimet në mbledhjet e departamentit dhe fakultetit, si dhe anketimet e studentëve. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përmbledh dhe analizon të dhënat nga pyetësorët, duke informuar strukturat përkatëse, përfshirë departamentin dhe dekanatin. Vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë e kryen gjithashtu Departamenti i Financës, i cili mbulon programin Master i Shkencave në “Financë”. Rezultatet e këtyre proceseve prezantohen në mbledhjet përkatëse dhe përfshihen në raportet vjetore të departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e brendshme e punës Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), FEUT, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.24 Plani i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) FEUT, për vitet akademike 2021-2025, 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në</p>	<p>GVJ vlerëson se, sipas RVB-së, në nivel institucional Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) harton çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Ky dokument ofron një analizë të funksionimit institucional të UT-së dhe të përmbushjes së standardeve të cilësisë për vitin akademik. Raporti përmbledh evidencat që shërbejnë për vlerësimin e standardeve në aktivitetet akademike dhe mësimore, duke lehtësuar identifikimin e nevojave dhe vendosjen e objektivave për përmirësimin e cilësisë.</p>

<p>mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizmin dhe funksionimin e njërive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.26 Udhëzues për funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) FEUT dhe formularë vlerësimi për lëndën dhe pedagogun</i></p> <p><i>Evidenca shtese -Evidenca mbi rezultatet e përfituara nga Paketa e Cilësisë NJSBC (1).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ evidentoi nga RVB plani i punës i NJSBC për vitin akademik 2024–2025. Instrumentet kryesore që përdor njësia, veçanërisht NJSBC, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorët për vlerësimin e moduleve nga studentët; • Pyetësorët për vlerësimin e pedagogëve nga studentët; • Formularët e vetëvlerësimit nga personeli akademik. <p>Të dhënat e mbledhura përpunohen nga NJSBC dhe transmetohen tek strukturat përkatëse, duke përfshirë departamentet dhe dekanatin. Monitorimi dhe analiza e cilësisë realizohet gjithashtu nga Departamenti i Financës, i cili mbulon programin Master i Shkencave në “Financë” si dhe aktivitetet kërkimore të stafit. Rezultatet diskutohen në mbledhjet departamentale dhe pasqyrohen në raportet vjetore të departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.26 Udhëzues për funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) FEUT dhe formularë vlerësimi për lëndën dhe pedagogun</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2025</i></p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimet me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të</p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni ka vendosur një sistem të integruar instrumentesh për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit. Ky sistem përfshin sondazhe dhe intervista me studentët, alumni, personelin akademik dhe</p>

<p>studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>ndihmësakademik, stafin administrativ, punëdhënësit, institucionet partnere dhe aktorët e tjerë të përfshirë në procesin mësimor dhe në vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të fituara. Të dhënat e mbledhura analizohen dhe i transmetohen strukturave përgjegjëse, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NjSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademike 2021-2025</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UT disponon struktura dhe instrumente të organizuara për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve.</i></p> <p><i>Procesi përfshin vlerësime nga studentët, alumni, stafi akademik dhe bashkëpunëtorët. Të dhënat e mbledhura analizohen nga NJSBC dhe strukturat përkatëse, dhe rezultatet paraqiten në mbledhje të organizuara dhe pasqyrohen në raportet vjetore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të</p>	<p>Sipas informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit të aplikimit pranë ASCAL-it dhe të dhënave të mbledhura gjatë vizitës në UT, GVJ vlerëson se kuadri rregullativ i institucionit siguron përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të</p>

<p>cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>jashtëm në proceset e sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Manuali i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcakton strukturën organizative, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e njësive përbërëse, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), FEUT, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësive të Sigurimit të Cilësisë (NjSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregulloret dhe udhëzimet përkatëse të institucionit dhe njësive bazë të programit përcaktojnë qartë rolin dhe përgjegjësitë e të gjitha njësive të përfshira në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit. Në nivel të Fakultetit të Ekonomisë, Dega e Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC bashkëpunojnë dhe ndajnë përgjegjësi të përbashkëta për koordinimin e këtyre proceseve.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UT siguron përfshirjen aktive të stafit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së programit, duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi ose pabarazie.</p> <p>NJSBC përbëhet nga anëtarë të stafit akademik dhe përfaqësues të njësive kryesore, ndërsa në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), grupi i vlerësimit përfshin edhe një student, duke garantuar përfaqësim të drejtpërdrejtë të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Vendimi i grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB).</i></p> <p><i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), FEUT, 2024-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.24 Plani i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC) FEUT, për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Vizita në Institucion nga GVJ</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në njësitë e ngritura për vlerësimin e cilësisë përfshihen si staf akademik, ashtu edhe studentët. GVJ nuk ka evidentuar raste pabarazie ndaj stafit apo studentëve, pasi proceset zhvillohen në mënyrë transparente dhe vendimmarrja merret në mënyrë të përbashkët nga të gjithë anëtarët. Në nivel institucional, Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, të cilët respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo formë diskriminimi apo pabarazie.</p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.1 Vendimi i grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB).</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se UT angazhon ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të fushës së ekonomisë dhe financës për të mbështetur proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. NJSBC përfshin në përbërje ekspertë të jashtëm me njohuri të specializuara. Aktivitetet si Panairi i Punës, leksionet e hapura me personalitete të fushës, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, janë kthyer në praktikë të rregullt universitare dhe përdoren nga strukturat përkatëse për të diskutuar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.16 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit e Standardeve të Cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.17 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njërive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.18 Paketa e dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.24 Plani i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC) FEUT, për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 Plani i veprimtarisë së NJSBC, UT, 2024-2028</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.33 Lista e marrëveshjeve ndër-institucionale kombëtare e ndërkombëtare me FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 3.16 Lista e leksioneve të hapura të zhvilluar në ciklin dytë të studimit në FEUT me pjesëmarrje të studentëve "Master të Shkencave në Financë", 2021-2025</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se Universiteti i Tiranës përfshin ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>Përveç kësaj, marrëveshjet institucionale, leksionet e hapura përdoren si mekanizma për të diskutuar dhe përmirësuar vazhdimisht programet e studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Aktet rregullative të institucionit, përfshirë rregulloren e UT, rregulloren e NJSBC dhe atë të Fakultetit të Ekonomisë, përcaktojnë qartë transparencën e rezultateve lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Gjetjet dhe problematikat që dalin nga raportet periodike të njësjes adresohen tek njësitë kryesore dhe bazë, ku diskutohen dhe kërkohen zgjidhje me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.23 Përbërja e Komisionit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), FEUT, 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të</p>	<p>Institucioni ka bërë publik vendimin për akreditimin institucional të datës 27.01.2023 në faqen zyrtare të UT, i cili është i vlefshëm për 6 (gjashtë) vite akademike, deri më 26.01.2029. Informacioni</p>

<p>programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>në nivel programi dhe departamenti përcillet tek strukturat përkatëse përmes shkresave zyrtare, ndërsa studentët njoftohen përmes faqes zyrtare dhe platformës e-student, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca 1.11 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT</i></p> <p>https://unitir.edu.al/akreditimi-periodik-i-universitetit-te-tiranes/</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në nivel institucional, Universiteti i Tiranës, në bazë të vendimit të akreditimit të vitit 2023, ka hartuar një plan masash për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe për të zbatuar rekomandimet e dhëna.</p> <p>Ky program studimi, i akredituar për herë të parë në Departamentin e Financës, monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme. Çdo problematikë e evidentuar trajtohet gjatë analizës vjetore të veprimtarisë, e cila zhvillohet çdo vit për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.10 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore e Departamenti i Financës FEUT, për vitet akademikë 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacionit të përfshirë në RVB, GVJ vuri re se në UT zhvillohen analiza periodike në nivel fakulteti dhe departamenti për zbatimin e politikave dhe strategjive, duke evidentuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme.</p> <p>Pas analizës mësimore-shkencore në departament, organizohet edhe analiza vjetore e veprimtarisë në nivel të Fakultetit të Ekonomisë. Në bazë të këtyre rezultateve, NJSBC ka hartuar planin e veprimit për vitin akademik 2024–2025. Përveç kësaj, periodikisht organizohet dita e informimit për studentët potencialë të programit, ku u ofrohet informacion i detajuar mbi procesin e regjistrimit.</p> <p><i>Evidenca 1.19 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 Plani i veprimtarisë së i NJSBC-së UT 2024-2028</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.18 Raporti vjetor i FEUT për veprimtarinë kërkimore dhe mësimore për vitet akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programit zhvillohet në takimet e njësisë bazë pra në Departamentin e Financës si dhe në nivelin e njësisë kryesore, Fakulteti i Ekonomisë i UT. Gjatë ditës së informimit për studentët potencialë, u ofrohet informacion i detajuar dhe i strukturuar mbi standardet dhe cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.30 Plani i veprimtarisë së i NJSBC-së UT 2024-2028</i></p> <p><i>Evidenca 2.24 Plani i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) FEUT, për vitet akademike 2021-2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.25 Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025.</i></p> <p><i>Evidenca 2.26 Udhëzues për funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) FEUT dhe formularë vlerësimi për lëndën dhe pedagogun</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UT siguron publikimin e informacionit të qartë dhe të detajuar mbi sigurimin e cilësisë për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Materialet dhe raportet e analizave respektojnë etikën akademike dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshijnë tregues të matshëm për efektivitetin e aktiviteteve dhe garantojnë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Fakulteti i Ekonomisë përfaqëson njësinë kryesore të programit të studimit me eksperiencën më të gjatë në Shqipëri, kontributin më të rëndësishëm në përgatitjen e specialisteve në fushën e financës dhe reputacionin më të mirë në sektorin e arsimit të lartë;
2. Departamenti i Financës si njësi baze e programit ka pasur gjate gjithë kësaj periudhe qëndrueshmëri dhe nivel të lartë akademik dhe profesional të stafit akademik. Kjo njësi është shume aktive në bashkëpunimin shkencor brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtare;
3. Programi i studimit MSH në Financë ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës është nder më të kërkuarat duke mos pasur konkurrence nga institucionet e tjera të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Kërkesat e kandidatëve për tu regjistruar në këto programe janë të larta. Si rrjedhojë edhe studentet që regjistrohen në këtë program studimit janë me rezultate të larta nga programi i studimit bachelor ku janë diplomuar duke garantuar cilësi në vlerësimin e njohurive të marra prej tyre;
4. Marrëveshjet e shumta që ka njësi kryesore dhe njësi baze me aktore të shumta të biznesit, institucioneve financiare, njësi të pushtetit qendror dhe lokal bëjnë të mundur suksesin e programit të studimit në kuadër të aftësisë profesionale dhe kërkimit shkencor për studentet e diplomuar në këtë program;
5. Njësia kryesore dhe ajo baze nëpërmjet formave të mësimdhënies, transmetimit të dijeve bashkëkohore dhe risive metodologjike në këtë proces realizojnë praktikën më të mirë me fokus studentin duke garantuar rezultatet pozitive në standardin e cilësisë;
6. Personeli akademik i përfshirë në program ka tituj dhe ekspertizë të specializuar në fushën e financës, duke garantuar një cilësi të lartë profesionale në mësimdhënie;
7. Eksperienca dhe kualifikimi i stafit akademik që ofron programin kontribuojnë në realizimin e objektivave mësimore me cilësi të lartë dhe në forcimin e praktikave të mira brenda institucionit;
8. Numri i pedagogëve PAE përputhet me ngarkesën mësimore sipas standardeve, duke garantuar mbulimin e plotë të të gjitha lëndëve të programit;
9. Institucioni siguron mjedise mësimore të përshtatura dhe infrastrukturë të specializuar që mbështesin realizimin e procesit mësimor dhe aktivitetet praktike të programit, në përputhje me natyrën dhe fushën e studimit;
10. Institucioni garanton fonde të qëndrueshme dhe mbështetje të rregullueshme, duke mundësuar zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe asistencën e studentëve gjatë gjithë programit;

11. UT përfshin ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm në aktivitetet e sigurimit të cilësisë dhe shfrytëzon evenimente institucionale, si leksionet e hapura, si platforma për të diskutuar dhe përmirësuar programet e studimit në mënyrë të vazhdueshme;

b. Pika të dobta:

1. Vërehet një aspekt që kërkon përmirësim në drejtim të përputhshmërisë së kualifikimeve të personelit akademik me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse të cilësisë në arsimin e lartë; *(Standardi IV.I; Kriteri 1)*

Rekomandime

1. Rekomandohet që institucioni të sigurojë angazhimin në procesin e mësimdhënies vetëm të personelit akademik që zotëron të paktën gradën shkencore “Doktor (Dr.)”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të përcaktuara në nenin 59, pika 6, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
2. Prej vitit 2022, programi Master Shkencor në “Financë” nuk ka pësuar ndryshime thelbësore në strukturën apo përmbajtjen e planit mësimor, përveç disa përshtatjeve të kufizuara në nivel lëndësh, të cilat janë bërë për të reflektuar zhvillimet më të fundit teknologjike dhe praktikat bashkëkohore në fushën e finances;

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in “Finance”

a. Strengths and affirmations:

1. The Faculty of Economics represents the main unit of the study program with the longest experience in Albania, the most important contribution to the preparation of specialists in the field of finance and the best reputation in the higher education sector;
2. The Department of Finance as the basic unit of the program has had throughout this period stability and a high academic and professional level of academic staff. This unit is very active in scientific cooperation within and outside the country through the organization and participation in scientific research activities at the national and international level;

3. The MSc in Finance study program offered by the Faculty of Economics and the Department of Finance is among the most sought-after, with no competition from other Higher Education institutions in Albania. The requirements of candidates to enroll in these programs are high. As a result, students who enroll in this study program have high results from the bachelor's study program where they graduated, guaranteeing quality in the assessment of the knowledge gained by them;
4. The numerous agreements that the main unit and the base unit have with numerous business actors, financial institutions, central and local government units make possible the success of the study program in the framework of professional training and scientific research for students graduated in this program;
5. The main and basic units, through teaching forms, transmission of contemporary knowledge and methodological innovations in this process, implement best practices with a focus on the student, guaranteeing positive results in the quality standard;
6. The academic staff involved in the program hold relevant academic titles and specialized expertise in the field of finance, ensuring a high professional standard in teaching;
7. The experience and qualifications of the academic staff delivering the program contribute to the achievement of high-quality learning outcomes and the strengthening of good practices within the institution;
8. The number of teaching staff corresponds to the teaching load according to standards, ensuring full coverage of all program courses;
9. The institution provides appropriate learning environments and specialized infrastructure that support the teaching process and practical activities of the program, in accordance with the nature and field of study;
10. The institution ensures sustainable funding and adequate support, enabling the development of the teaching and research process, as well as the assistance of students throughout the program;
11. UT involves external experts and collaborators in quality assurance activities and utilizes institutional events, such as open lectures, as platforms to continuously discuss and improve the study programs;

b. Weaknesses:

1. An aspect requiring improvement is observed regarding the alignment of academic staff qualifications with the legal requirements and relevant quality standards in higher education; (*Standard IV.1; Criterion 1*)

Recommendation

1. It is recommended that the institution ensure the engagement, in the teaching process, of only academic staff holding at least the scientific degree of “Doctor (PhD)”, in accordance with the legal requirements and quality standards set forth in Article 59, paragraph 6, of Law No. 80/2015 “On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania”;
2. Since 2022, the Master of Science program in “Finance” has not undergone significant changes in the structure or content of the curriculum, except for a few limited course-level adjustments made to reflect the latest technological developments and contemporary practices in the field of finance;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X